

1 E premte, 20 maj 2022

2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit marrin pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 15.30

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita. Mirë se vini, të  
7 gjithë këtu brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Znj. Asistente e Gjykatës, ju lutem të deklaroni lëndën e  
9 çështjes.

10 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar  
11 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
12 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
13 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Asistente e  
15 Gjykatës.

16 Ju kërkoj ndjesë, në emër të Gjykatës për këtë vonesë. Ka  
17 patur disa probleme me lidhjen mes Gjykatës dhe pjesës tjetër  
18 të pjesëmarrësve që ka dhe janë shkaktuar disa vështirësi për  
19 këtë seancë. Sidoqoftë tashmë duket sikur janë zgjidhur këto  
20 probleme që kemi patur dhe shoh në ekran të gjithë njerëzit,  
21 kështu që mund të vazhdojmë më tutje.

22 Informoj të akuzuarit dhe palët që marrin pjesë në  
23 distancë me internet që të na informoni menjëherë nëse keni  
24 probleme të lidhjes me sistemin, pra, në rast se na rishfaqen  
25 edhe njëherë çështjet edhe defektet që kemi patur.

1 Tani po i kaloj palëve që të prezantohen duke filluar me  
2 Prokurorinë.

3 Vazhdoni z. Prokuror.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës. Në  
5 emër të ZPS-së është Alan Tieger, Ward Ferdinandusse, Volle-  
6 Marvaldi dhe unë jam Prokurori Matt Halling.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

8 Tani kalojmë te palët Mbrojtëse, z. Kehoe.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit. Gregory Kehoe, Sophie  
10 Menegon në emër të z. Thaçi.

11 Mirëdita.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

13 Z. Emmerson.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Mirëdita, i  
15 nderuar Gjykatës dhe të gjitha atyre që janë në sallën e  
16 gjyqit dhe jashtë saj. Unë jam Ben Emmerson dhe përfaqësoj  
17 Kadri Veselin së bashku me kolegët e mi të cilët janë në  
18 sallën e gjyqit Andrew Strong dhe Annie O'Reilly, Pascale  
19 Langlais, bashkë i asociuar; dhe bashkë me ne është Gabriel  
20 Caon, inter; dhe Shefi i Hetimeve në Kosovë na është bashkuar  
21 neve sot.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani z. Young.

23 Z. YOUNG: [Përkthim] Jam këtu në emër të z. Rexhep  
24 Selimi. Sot i kam bashkëkolegët e mi Geoffrey Roberts, Rudina  
25 Jasini dhe Skendo.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Mirëdita. Jam përfaqësuesja e  
2 z. Krasniqi. Së bashku me Aidan Ellis që është -- z. Victor  
3 Baiesu dhe Mentor Beqiri, i cili na është bashkuar me  
4 vidiolidhje sot.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.  
6 Alagendra.

7 Tani Mbrojtësi i Viktimave.

8 Z. Laws.

9 LAWSON: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve. Unë jam Simon  
10 Laws, Mbrojtësi i Viktimave në këtë çështje, së bashku me  
11 Radziejowska, kolegen time.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Laws.

13 Dhe tani z. Nilsson në emër të Zyrës Administrative.

14 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.  
15 Mirëdita kolegë. Jonas Nilsson që jam përfaqësuesi i  
16 Shërbimeve Juridike për Zyrën Administrative.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe vërej për  
18 procesverbalin, që z. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë  
19 të lidhur me videolidhje.

20 Dhe unë, përsëri po e them për procesverbalin, jam  
21 Nicolas Guillou, përgjegjës i kësaj çështje.

22 Më datën 12 maj 2022, unë caktova datën për këtë  
23 konferencë të dymbëdhjetë. I kërkova palëve që të bëjnë  
24 parashtrimet e tyre nëse dëshirojnë.

25 Më 18 maj 2022, ZPS-ja dhe tre ekipet e Mbrojtjes kanë

1 dorëzuar parashtrimet e tyre të shkruara. I falënderoj palët  
2 për këto vëzhgime të shkruara.

3 Synimi im i seancës së ditës së sotme, si zakonisht,  
4 është për të parë ecurinë e çështjes dhe për të diskutuar  
5 temat e rendit të ditës; në mënyrë më të posaçme, çështjen e  
6 nxjerrjes së materialeve, hetimet e palës Mbrojtëse dhe hapat  
7 e mëtejshëm dhe propozimet për ta thjeshtëzuar çështjen. Tani  
8 do t'u kërkoj palëve që të paraqesin pikëpamjet e tyre në  
9 mënyrë sa më shkurtër për secilën prej këtyre pikave.

10 Po para se të kalojmë tek pika e parë e rendit të ditës,  
11 si çështje paraprake, desha të sqaroja kalendarin e punës për  
12 kërkesat për leje për të apeluar kundër vendim tim të fundit  
13 që ka konfirmuar amendimet e Aktakuzës.

14 Vërej se në datën 2 maj 2022, unë urdhërova Mbrojtjen e  
15 Thaçit dhe palët e tjetra që të kërkojnë leje për të apeluar  
16 kundër vendimit të amendamenteve të konfirmimit dhe për t'i  
17 paraqitur parashtresat e tyre mbi pranueshmërinë e këtyre  
18 kërkesave përpara datës, ditës së hënë, 23 maj 2022.

19 Vërej po kështu se më datën 10 maj 2022, urdhërova ZPS-në  
20 që të dorëzonte përgjigjen e saj për kërkesën e Veselit për  
21 leje për ta apeluar kundër vendimit të konfirmimit të  
22 amendamenteve të konfirmimit para datës 23 maj 2022.

23 Duke parë njoftimin e Mbrojtjes, parashtrimin e fundit të  
24 Thaçit, F799, që nuk do të bëjë kërkesë për të marrë leje për  
25 të apeluar kundër këtij vendimi, doja të dëgjoja nga palët e

1 tjera të Mbrojtja nëse ato synojnë që të kërkojnë leje për të  
2 apeluar apo për të paraqitur parashtrimet e tyre lidhur mbi  
3 pranueshmërinë e këtyre kërkesave.

4 Dhe tani po e filloj me Mbrojtjen e Selimit.

5 Z. Young, ju e keni fjalën.

6 Z. YOUNG: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, jo, ne nuk do të  
7 bëjmë parashtrime.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

9 Znj. Alagendra.

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo, as ne nuk do të bëjmë  
11 parashtrime, i nderuar Gjykatës.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

13 Alagendra.

14 Z. Kehoe.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Ne e kemi paraqitur qëndrimin tonë  
16 në dokumentin tonë.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. Emmerson, a dëshironi të thoni gjë.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo. Vetëm  
20 znj. O'Reilly ndoshta ka ndonjë gjë për të shtuar.

21 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Jo. I nderuar Gjykatës, ne i  
22 kemi bërë parashtrimet tona. Ato i kemi bërë përpara se ju të  
23 nxirrnit urdhrin tuaj. Dhe, siç e kemi thënë atje, kemi nevojë  
24 për disa sqarime lidhur me çështjen e papranueshmërinë. Kaq.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

1 Pra, në duke parë këto parashtime dhe për ta  
2 thjeshtëzuar kalendarin e punës së kësaj çështje, do të nxjerr  
3 urdhrin e parë gojor.

4 Unë e urdhëroj ZPS-në që të bëjë parashtime, nëse  
5 dëshiron, lidhur me pranueshmërinë e kërkesës që ka bërë  
6 Veseli në bazë të rregullit 77 në përgjigjen e saj që ishte  
7 përpara datës 23 maj 2022.

8 I kërkoj po ashtu Mbrojtjes së Veselit që  
9 kundërpërgjigjen ndaj përgjigjes së ZPS-së ta dorëzojnë para  
10 datës 3 qershor, pra, të premtes, 3 qershor 2022 dhe për të  
11 përfshirë aty parashtimet e tyre lidhur me pranueshmërinë e  
12 kërkesës së lejes për të apeluar.

13 Dhe këtu përfundon urdhri im i parë gojor.

14 Të kalojmë tani tek pika e parë e rendit tonë të ditës që  
15 ka të bëjë me nxjerrjen e materialeve.

16 Së pari do t'ia jap fjalën palëve lidhur me secilën prej  
17 kategorive të materialeve, si zakonisht. Së pari do të  
18 fillojmë me materialin e rregullës 103, që është material  
19 shfajësues, siç është parashikuar dhe në kalendarin e punës;  
20 pastaj materialet e rregulli 102(3), material që është në  
21 listën e ZPS-së; dhe së treti materiali i rregullës 107, që  
22 është material i mbrojtur për të cilin kërkohet leja e palës  
23 dhënëse.

24 Ta fillojmë me materialet shfajësuese, duke qenë se është  
25 edhe materiali kryesor provë i cili mbetet për t'u nxjerrë apo

1 për t'ju dhënë palës Mbrojtëse.

2 Që nga konferenca e fundit e ecurisë së çështjes, ZPS-ja  
3 ka nxjerrë më shumë se 1000 dokumente në bazë të rregullit 103  
4 në 14 paketa, nëse nuk e kam gabim, duke qenë që paketa e  
5 fundit është nxjerrë vetëm gjatë mëngjesit të ditës së sotme.

6 Në parashtrim e saj, ZPS-ja ka thënë që e ka përfunduar  
7 analizën fillestare të provave shfajësuese që kanë në  
8 posedimin e saj deri në fund të janarit 2022. Këtu përfshihen  
9 2500 materiale apo dokumente, shqyrtimi i të cilave është  
10 urdhëruar gjatë konferencës së fundit të ecurisë së çështjes.

11 Megjithatë, ZPS-ja thotë që nxjerrja materialeve të  
12 rregullit 103 do të vazhdojë siç vazhdon me të gjitha çështjet  
13 e kësaj natyre. ZPS-ja po kështu thotë se do të bëjë kërkime  
14 të tjera të hollësishme gjatë gjithë procedurave për të bërë  
15 të mundur që dëshmitarët që do të vijojnë të mbulohen të tërë  
16 nga dispozitat e nxjerrjes së rregullit 103.

17 Mbrojtja e Thaçit ka shprehur shqetësimin që një numër  
18 kaq i madh i material shfajësuese është nxjerrë vetëm tani nga  
19 ZPS-ja. Ajo i ka kërkuar ZPS-së po kështu të konfirmojë se sa  
20 është sasia e materialeve shfajësuese që ato kanë apo për të  
21 cilat kanë njohuri, kur ky material që ato e kanë në posedim  
22 do të nxirret plotësisht.

23 Mbrojtja e Veselit dhe e Krasniqit kanë kërkuar po kështu  
24 një urdhër që t'i kërkojë ZPS-së që ta përfundojë të gjithë  
25 nxjerrjen e materialeve të rregullës 103 para datës 22 qershor

1 2022.

2 I kërkoj ZPS-së që t'i përgjigjet pyetjeve që kanë  
3 ngritur Mbrojtja dhe për të thënë nëse ato kanë ndonjë  
4 material që është në posedimin e tyre që nga fundi i janarit  
5 2022, për të cilin duhet bërë rishikimi apo analiza për të  
6 shikuar nëse janë materiale shfajësuese. Nëse, po, a mund të  
7 angazhohet ZPS-ja për ta bërë këtë përpara konferencës së  
8 ardhshme të ecurisë së çështjes?

9 Z. Prokuror, ju e keni fjalën.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
11 Për sa i përket pyetjeve tuaja i keni përmbledhur si duhet.

12 Ne kemi përfunduar analizën deri në fund të janarit 2022.  
13 Deri më tani ne kemi nxjerrë mbi 5500 dokumente në bazë të  
14 rregullit 102 për palët Mbrojtëse.

15 Ne po përgatisim masat mbrojtëse lidhur me disa materiale  
16 të rregullës 103, të cilat do t'i dorëzojmë para fundit të  
17 këtij muaji.

18 Për sa i përket parashtrimet me shkrim të palëve  
19 Mbrojtëse, për sa i përket përfundimit të rregullit 103 dhe  
20 fundit të muajit, që përmendët ju, apo të konferencës së  
21 ardhshme të ecurisë, po, ne mund ta bëjmë këtë. Ne kjo punë  
22 vazhdon, analiza, pra, vazhdon. Dhe ne të gjitha materialet  
23 103 që do t'i sigurojmë do t'i vazhdojmë gjatë gjithë kësaj  
24 procedure penale për të parë nëse kanë, pra, materiale  
25 shfajësuese.



1 Do t'i përfundojmë të gjitha materialet që kemi marrë  
2 përpara konferencës së ardhshme të ecurisë së çështjes. Kështu  
3 që afatet e paraqitura nga pala Mbrojtëse, në parashtrimet e  
4 saj, me shkrim janë të panevojshme.

5 Sa herë që ZPS-ja të marrë materiale të rregullës 103, ne  
6 do të vazhdojmë t'i nxjerrim ato. Siç e kam thënë në  
7 parashtrimet tona me shkrim, sa herë që të vijjnë këto  
8 materiale të kësaj natyre, ne do t'i analizojmë dhe do t'i  
9 nxjerrim sipas rastit.

10 Ne nuk duam të kemi konfuzion për sa i përket çështjes që  
11 do të vazhdojë nxjerrja e materialeve 103, ndërkohë që edhe  
12 materialet ekzistuese do të mund të analizohen herë pas here.  
13 Dhe shkalla dhe sasia e këtyre materialeve bën që ky të jetë  
14 një proces shumë i rëndësishëm - ky është edhe në vijim si të  
15 praktikave më të mira që janë zhvilluar gjatë Tribunalit të  
16 Hagës dhe materialeve të tjera të gjykatës Penale  
17 Ndërkombëtare - ne do të vazhdojmë analizimin e të tëra  
18 materialeve për të parë nëse ka materiale shfajësuese. Do ta  
19 bëjmë këtë gjatë gjithë ecurisë së çështjes.

20 Megjithëkëtë analiza fillestare ka përfunduar dhe ne jemi  
21 të gatshëm me këtë t'i hapim rrugën, pra, përgatitjes për  
22 gjyq.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, kur thoni ju "që keni  
24 përfunduar analizën fillestare", e keni fjalën për materialet  
25 të cilat ju i keni pasur në dorë deri në 31 janar 2022. Por jo

1 për jo për materialet që keni marrë që nga ajo datë?

2 Z. HALLING: [Përkthim] E saktë. Ne do të analizojmë këto  
3 dhe materialet e tjera që do të sigurojmë. Ju përmendët kohën  
4 e konferencës së ardhshme të ecurisë së çështjes, i nderuar  
5 Gjykatës dhe ky është një afat i përshtatshëm për neve.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

7 Z. Kehoe.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

9 Një nga problemet kryesore në mënyrën sesi është trajtuar  
10 kjo çështje nga ZPS-ja është se ata kanë dështuar për t'i bërë  
11 gjërat në momentin e duhur. Kolegët tanë, kolegu im dhe  
12 kolegët e tjerë, janë të interesuar që kjo çështje të ecë me  
13 shpejtësinë e duhur për të kaluar në gjykim. Ka vite dhe ne  
14 vazhdojmë të presim materiale të rregullës 103, materiale të  
15 cilët ju, i nderuar Gjykatës, i keni thënë shpeshherë  
16 Prokurorisë për t'i nxjerrë menjëherë.

17 Dhe fjala "menjëherë", i nderuar Gjykatës, nënkupton  
18 "tani", është tani dhe jo kur dëshiron ta bëjë këtë ZPS-ja.  
19 Dhe dua t'ju paraqes juve vonesën lidhur me dëshmitarët që na  
20 janë dhënë në ditët e fundit.

21 Paketa 249, e 18 majit 2022, për shembull. Është material  
22 që është i 5 shkurtit 2015, për shembull.

23 Në Paketën 248, që është nxjerrë një ditë përpara më  
24 datën 17 maj 2022, janë transkriptet e intervistave që kanë  
25 bërë ZPS-ja në dhjetor 2019, shkurt 2019, prill 2019, maj

1 2019.

2 Në Paketën 242, më 13 maj 2022, ka shënime të takimeve që  
3 ka bërë ZPS-ja në 16 dhjetor 2016 dhe janar 2017.

4 Dhe kjo nuk është nxjerrje e menjëhershme.

5 Ky argumenti që ky nuk është informacion i rëndësishëm  
6 për klientin tim apo për të tjerët, këtu bëhet fjalë për  
7 personel të OSBE-së dhe të UNMIK-ut, që janë individë kyç në  
8 terren në atë kohë. Materiali i rregullit 103 për të cilët po  
9 na jepet vite-vite pasi ato e kanë marrë, pasi ato e kanë  
10 patur në posedim, pra, ZPS-ja. Dhe, i nderuar Gjykatës, kur ju  
11 dhatë urdhër për nxjerrje të menjëhershme të këtyre  
12 dokumenteve nuk kishit parasysh vite të tëra.

13 Çfarë sjell një gjë e tillë? Kjo bënë që të shpenzohen  
14 kohë dhe përpjekje shumë më të madha për të gjetur këto  
15 materiale shfajësuese për të cilat ZPS-ja i ka patur në dorë  
16 gjatë gjithë kohës. Dhe nuk ka asnjë pretekst dhe kjo është  
17 arsyeja përse ne kemi kërkuar që të vijë një mbikëqyrës i  
18 pavarur për t'i analizuar këto materiale shfajësuese për të na  
19 i nxjerrë neve në kohën e duhur. Dhe kjo nuk ka ndodhur.

20 Ndërkohë që tani po bëjmë një diskutim paksa amorf për sa  
21 i përket nxjerrjes së materiale shfajësuese të rregullit 103  
22 të janarit 2022. Sa informacion kanë ato në dorë? Çfarë  
23 përmban ky informacion? Që të gjitha këto ndikojnë mbi  
24 klientët tanë për sa i përket elementit kohor. Janë ata të  
25 cilët janë në njësinë e paraburgimit. Janë ata të cilët vuajnë

1 nga këto vonesa, janë ata të cilët duan që çështja të shkojë  
2 në gjykim, megjithëkëtë, ne nuk po na jepen këto materiale  
3 shfajësuese.

4 Ju e kuptoni, i nderuar Gjykatës, që këtu bëhet fjalë për  
5 nxjerrjen e menjëhershme, siç e keni thënë me urdhrat tuaja  
6 shumë herë. Megjithëkëtë, i nderuar Gjykatës, një gjë një e  
7 tillë nuk po ndodh.

8 Shqetësimi kryesor që ne kemi me materialet e 103, ka të  
9 bëjë me kërkesën e posaçme nga ZPS-ja për kontakte që kanë  
10 mbajtur dëshmitarët e listës së tyre me organe të shtetit  
11 serb. Dhe ne duam të shohin nëse burimi i Mbrojtjes që ka -- i  
12 dëshmive që ka ZPS-ja, duam të dimë nëse vjen në mënyrë të  
13 drejtpërdrejtë apo nga Republika Serbe dhe organet e tyre. Ne  
14 morëm përgjigje nga ZPS-ja për këtë çështje në mars. E morëm  
15 këtë më datën 20 prill 2022.

16 Dhe kanë thënë kështu:

17 "ZPS-ja nuk e pranon pohimin që provat e siguruara nga  
18 autoritetet serbe vijnë me ndihmën e tyre" dhe këto nuk janë  
19 materiale që cilat janë "automatiksht pjesë e rregullit 103.  
20 ZPS-ja në bazë të nenit 55 të Ligjit, mund të kërkojë  
21 bashkëpunimin e shteteve të treta dhe kjo nuk do të ndikojë  
22 mbi besueshmërinë e dëshmive që paraqet ZPS-ja".

23 ZPS-ja e ka një zyrë në Beograd. Dhe nuk kanë gjetkë. Ata  
24 bashkëpunojnë me autoritet serbe. Dhe çfarë dimë ne për sa i  
25 përket falsifikimit të rasteve që mund të kenë bërë autoritet

1 serbe me qëllim që t'i fajësojnë klientët tanë të Kosovës.

2 Kolegu im, z. Young, foli për rastin Panda herën e fundit. Për  
3 këto incidente, në të cilët serbët vranë individë serbë për të  
4 fajësuar shqiptarët.

5 Dhe, siç e thatë edhe ju, kjo ndodhi në vitin 1992. Kjo  
6 që po themi ne ndodhi në vitin 2022. Dhe i përmirëson këto  
7 trillimi si të thuash. Ku ndodhemi tani? Ku ndodhemi  
8 aktualisht për sa i përket bashkëpunimit të ZPS-së me  
9 autoritet serbe, duke mbajtur parasysh që dokumenti themeltar  
10 i kësaj Gjykate është raporti i Marty. Dhe ajo që është  
11 raportuar në atë libër dhe në median në televizionin në  
12 Beograd është që ish-ambasadori i Serbisë në Zvicër ishte  
13 përgjegjës së bashku me organet serbe që t'i dorëzonte z.  
14 Marty më shumë se 1000 dokumente. I kanë dhënë, pra, z. Marty  
15 më shumë se 1000 dokumente. E kanë bërë këtë në sekret në  
16 vitin 2009.

17 Ambasadori, Milan St. Protic tha që raporti i Marty është  
18 i bazuar në mijëra faqe që z. Marty ka marrë nga serbët. Dhe  
19 ai thotë më tej, vëren më tej dhe kjo vjen në një nga  
20 intervistat që janë bërë në një nga shfaqet televizive në  
21 Beograd:

22 "Po të mos ishte se ka ekzistuar raporti i Prokurorëve të  
23 Krimeve të Luftës serbisht nuk do të kishte pasur as raport të  
24 Marty"

25 Pra, ai e ka shprehur me krenari sesi raporti i Marty

1 ishte i mbushur me informata të cilat z. Marty i kishte marrë  
2 nga organet serbe kërkimore.

3 Kalojmë tani me shpejtësi më të madhe. Çfarë ka ndodhur  
4 tashmë më së fundmi? Ajo që ka ndodhur më së fundmi është që  
5 është zbuluar një përpjekje për të vrarë Dick Marty. Dhe ne e  
6 kemi paraqitur këtë në parashtrimin tonë për lirimin deri në  
7 gjykim. Çfarë ka ndodhur si rezultat i kësaj?

8 Ajo që ndodhi është se autoritet serbe nxorën një  
9 kontratë për vrasjen e z. Marty për të fajësuar për këtë  
10 shqiptarët e Kosovës.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe, këtu po flasim  
12 për materiale shfajësuese --

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe ajo për të cilën po flas unë, i  
14 nderuar Gjykatës, është për të thënë që qëndrimi i tyre është  
15 në kundërshtim me 103-shin. Për shkak të marrëdhënieve që ato  
16 kanë me Serbinë. Dhe e kam cituar këtë shumë herë, i nderuar  
17 Gjykatës. Është materiali 103 i cili ndikon mbi besueshmërinë  
18 e provave që paraqet ZPS-ja.

19 Pra, kemi një situatë, në qoftë se del një kontratë për  
20 vrasjen e z. Dick Marty edhe krijohet një operacion i fshehtë  
21 për të vrarë z. Marty. Dhe kur ndodhi kjo? Kjo ndodhi pak pasi  
22 klientët tanë u sollën këtu në Hagë nga fundi i 2020-s. Doli  
23 kjo kontratë dhe shërbimi sekret zviceran e zbuloi një gjë të  
24 tillë.

25 Dhe z. Marty -- dhe, në qoftë se ju i vini pikëpyetjen

1 çështjes nëse kjo ishte një kanosje e vërtetë, shërbimet  
2 sekrete zvicerane e kanë marrë në mbrojtje z. Marty dhe  
3 atëherë është në këtë intervistë: "Dhe kanosja vjen nga disa  
4 qarqe të shërbimeve sekrete serbe të cilët i kanë kërkuar  
5 krimin të fshehtë që të [më] likuidojnë mua për të fajësuar  
6 shqiptarët e Kosovës. Dhe janë pjesë e botës së krimin" --

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe, kaloni tek  
8 argumenti që kanë të bëjnë me materialet shfajësuese. Këtu po  
9 flitet për kalendarin e nxjerrjes së materialeve shfajësuese.  
10 Në qoftë se ju jeni kundërshtoni mënyrën sesi ZPS-ja e  
11 interpreton këtë material, atëherë bëheni këtë gjë. Jemi shumë  
12 vonë dhe kemi ditë shumë të ngjeshur.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, problemi është  
14 se qëndrimi i marrëdhënieve që ka ZPS-ja me organet serbe  
15 duhet të jetë i të njëjtit nivel me gjithë të tjerët, me ato  
16 që ka me të tjerët. Ne duhet të dimë se cila është origjina e  
17 dokumenteve që nxjerr ZPS-ja para këtij Trupi Gjykses, duam të  
18 dimë nëse ato vijnë nga shërbimi sekret serb apo organet  
19 hetuese të Serbisë.

20 Dhe arsyeja se përse përmenda situatën e Marty është se  
21 kanosja që vjen nga shërbimet serbe të zbulimit për të  
22 infiltruar dhe për të penguar drejtësinë në këtë çështje. Dhe  
23 kjo vazhdon edhe sot e kësaj dite. Kështu që, për rrjedhojë,  
24 të gjitha dokumentet që ata i sigurojnë nga zyrat e shërbimeve  
25 sekrete serbe apo zyra e tyre e Prokurorisë, duke pasur

1 parasysh historikun që ka të bëjë me këto materiale, i gjithë  
2 ky është material i 103. Dhe ky është argumenti që kemi.

3 Pra, desha t'ju thosha që këtu është një kanosje serioze  
4 dhe një mënyrë për ta zgjidhur këtë është që të nxjerrin të  
5 gjitha dokumentet që i marrin nga serbët të na jepen neve.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

7 Do i jap fjalën palëve të tjera për të diskutuar këtu  
8 çështje që kanë të bëjë me materialet e rregullit 103, pra,  
9 materialet shfajësuese.

10 Z. Emerson.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar  
12 Gjykatës, a mund të trajtoj tre çështje?

13 E para edhe kjo është një sqarim që kërkoj apo kërkesë  
14 për sqarim. Ju, i nderuar Gjykatës, në konferencën e fundit të  
15 ecurisë së çështjes, urdhëruat që dokumentet dhe informacioni  
16 që ZPS-ja ka në zotërim deri në janar që ishte rreth 2500  
17 dokumente, duhet të analizoheshin dhe nxirreshin.

18 Në parashtrimet e kujdesshme me shkrim apo me gojë, na  
19 është thënë që kjo analizë ka përfunduar. Duhet sqarim nëse  
20 Prokuroria po pohon këtu që ka nxjerrë të gjitha dokumentet të  
21 cilat kërkohet që të nxirren në bazë të rregullës 103, pra, si  
22 rezultat i analizës së këtij materiali deri në këtë ditë apo  
23 datë. Pasi na thanë që ka përfunduar, një numër materialesh na  
24 janë nxjerrë në bazë të rregullit 103.

25 Por nuk na është thënë haptazi, nëse ZPS-ja, në fakt, e



1 ka zbatuar urdhrin tuaj që para 20 majit të nxirren të gjitha  
2 dokumentet të cilat janë pjesë e nenit 103 dhe kjo pas asaj që  
3 na thanë që na thanë që është një analizë gjithëpërfshirëse e  
4 këtyre dokumenteve.

5 Në qoftë se kjo që po them unë nuk është një përmbledhje  
6 e saktë e qëndrimit të ZPS-së, atëherë ato të ftohen ta  
7 sqarojnë qëndrimin e tyre për të arritur, për të na treguar se  
8 përse nuk e kanë respektuar afatin kohor dhe për të na treguar  
9 se ku ndodhemi tani.

10 E dyta, është tejet e rëndësishme që ZPS-ja të mos  
11 lejohet të adoptojë një praktikë të nxjerrjes së materialeve  
12 shfajësuese pak çaste para se vijë për të dhënë dëshmi një  
13 dëshmitar para Trupit Gjykses. Kemi një formulim të ri tani  
14 nga ana e ZPS-së. Sigurisht, që ato e kanë këtë detyrim për të  
15 nxjerrë materiale shfajësuese deri në përfundim të provave të  
16 tyre. Dhe çështja e rëndësisë është e rëndësishme dhe duhet ta  
17 vazhdojnë një gjë të tillë dhe duhet ta bëjnë dhe të  
18 analizojnë ato që kanë nxjerrë deri më tani dhe këtë, më pas,  
19 përmes kërkimeve të tjera të posaçme, të mund të kërkohen  
20 materialet të cilat duhen nxjerrë para dëshmitarit i cili do  
21 të vijë, që ka dalë në dritë që nga ajo kohë. Pra, kjo është  
22 një analizë e logjikshme e detyrimit të vazhdueshëm për të  
23 nxjerrë materialet shfajësuese.

24 Në qoftë se këtë po thotë ZPS-ja, dakord. Megjithatë jemi  
25 të shqetësuar se kur flitet për kërkime të posaçme, pala e

1 ZPS-së nuk po i bën këto kërkime tani apo nuk i ka përfunduar  
2 këto kërkime dhe në këtë mënyrë duke i lejuar vetes së tyre  
3 liri të pafundme.

4 Dhe ajo pyetja që ngre unë është që ju të lëshoni një  
5 urdhër që, në qoftë se ato nuk i kanë përfunduar këto kërkime  
6 deri në fillim të gjyqit, të mos lejohen që këtë proces ta  
7 shtyjnë në pafundësi. Pra, që këto kërkime të jenë pjesë e  
8 këtij procesi të nxjerrjes që, në qoftë se, për shembull,  
9 afati i majit të 2022-shit kishte të bënte me materialet e  
10 janarit, do të doja nga ju, i nderuar Gjykatës, të sqaronin  
11 nëse për këto materiale janë bërë të gjitha kërkimet e duhura  
12 ose si pjesë e analizës dhe janë materialet të cilët janë  
13 nxjerrë për ne, pasi gjuha e përdorur mund të interpretohet në  
14 mënyra të ndryshme.

15 Ndërkohë që ne e pranojmë që ekziston detyrimi për  
16 nxjerrje edhe gjatë gjyqit. Ky nuk është një pretekst për të  
17 mos e bërë këtë nxjerrje të materialeve tani. Në qoftë se  
18 materialet nxirren gjatë kohës së gjykimit, materiale të cilat  
19 duhet të ishin nxjerrë që tani në bazë të urdhrave që keni  
20 lëshuar ju, atëherë kjo do të krijojë vonesa të konsiderueshme  
21 gjatë procesit të gjykimit pasi të gjithë, në fakt, duhet të  
22 pezullojmë çështjen për ta drejtuar këtë çështje.

23 Po e paraqes këtë tani për të thënë që ne nuk presim që  
24 të dalin materialet e tjera si rezultat i këtyre kërkimeve të  
25 posaçme, përveç materialeve të cilat Prokuroria do t'i

1 sigurojë pas afatit të 20 majit dhe afati i 20 majit kishte të  
2 bënte me materialet e janarit.

3 Dhe për sa i përket materialeve që Prokuroria dëshiron që  
4 t'i analizojë përpara konferencës së ardhshme të ecurisë,  
5 detyrimi i tyre është që t'i analizojnë dhe t'i nxjerrin deri  
6 në konferencën e ardhshme të ecurisë dhe jo thjesht për t'i  
7 analizuar dhe këtu duhet të përfshihet edhe çështja e  
8 kërkimeve të detajuara. Shqetësimi ynë është që ne duhet të  
9 arrijmë të kuptojmë që ZPS-ja i ka materialet të cilat do t'i  
10 nxjerrë, materiale të cilat janë të redaktuara, por nuk na ka  
11 treguar se cili është volumi i këtyre materialeve të cilat  
12 duhen të ishin nxjerrë brenda datës 20 maj me redaktimet e  
13 duhura, nëse është e nevojshme dhe materiale të cilat ato nuk  
14 i kanë nxjerrë tashmë.

15 Ne po kështu jemi të shqetësuar për sa i përket gjuhës që  
16 ka të bëjë "me praktikat më të mira të Gjykatës Penale  
17 Ndërkombëtare dhe Tribunalit të Hagës" dhe ky ishte citim më  
18 duket, në fakt. Përse po ngrihet kjo çështje në qoftë se është  
19 e qartë që detyrimi është i vazhdueshëm, apo ZPS-ja po kërkon  
20 të mbulojë pikërisht mungesën për të bërë këto kërkime të  
21 hollësishme në këtë vështrim. Ky është qëndrimi i dytë.

22 E treta ka të bëjë me jehonën, si të thuash, që i bëjmë  
23 z. Kehoe për sa i përket materialeve të nxjerra në bazë të  
24 rregullit 103 dhe të cilat i përkasin një periudhe shumë të  
25 hershme që nga 2015 deri në 2017, materiale të cilat i ka

1 gjeneruar vetë ZPS-ja.

2 E dyta, dëgjojmë ndryshimin e pikëpamjeve mes z. Kehoe  
3 dhe ZPS-së për sa i përket materialeve për faktin nëse  
4 materialet që janë nga burimet serbe janë të dyshuese dhe ne  
5 do të theksojmë këtu që ekzistojnë prova nga procesverbalet e  
6 Tribunalit të Hagës, për shembull, që shërbimet e zbulimit të  
7 Serbisë kanë kërkuar që ta korruptojnë dëshminë e cila është  
8 paraqitur para Trupit Gjykues. Një dëshmitar e ka pranuar një  
9 gjë të tillë në mënyrë specifike, pra, që ai ishte dërguar si  
10 dëshmitar nga shërbimet sekrete serbe dhe dëshmia e tij ishte  
11 e rreme.

12 Pra, ne nuk e pranojmë pohimin që Serbia i ka gjetur  
13 shenjat e gishtave mbi të gjitha dëshmitë dhe nëse ka ndodhur  
14 një gjë e tillë, ai është material i cili do të diskretitojë  
15 çështjen e Prokurorisë në Tribunalin e Hagës.

16 Janë dhënë dëshmi që shërbimi sekret serb, që nga niveli  
17 më i lartë i shefit të shërbimit sekret për Kosovën, kanë  
18 marrë pjesë në praktika të ndryshme të kanosjes, të  
19 kërcënimit, të ryshfetit për individë të ndryshëm duke i  
20 detyruar ata që të nënshkruajnë dokumente të cilat Prokuroria  
21 do t'i vendosë në tabelën e saj të dokumenteve, për të cilat  
22 nuk do të dëgjohet dëshmi gojore.

23 Pra, materialet që vijnë nga zyrtarët serbë, duhet të  
24 prezumohet që janë të korruptuar për shkak se ato kanë një  
25 qëndrim partizan të njëanshëm dhe ne do të sugjeronim që ZPS-

1 ja është shndërruar në një mjet i manipulimit në këtë çështje.

2 I nderuar Gjykatës, do të jap nja dy shembuj. I pari ka  
3 të bëjë me një periudhë pesëvjeçare, informacion që ka të bëjë  
4 me faktin që ZPS-ja është mbështetur në një kriminel lufte  
5 serb, i shpallur fajtor për këto krime. Dhe krahas kësaj, siç  
6 e di i nderuar Gjykatës edhe një proces ndërgjyqësor, pra, një  
7 prej kundërshtimeve që i kemi bërë ne, Prokuroria, për  
8 shembull, vazhdon që të mbështetet tek një dëshmitar në rastin  
9 e incidenteve që kanë të bëjnë me z. Veseli që është Nazim  
10 Bllaca, që ka vdekur, ka informacione që në vitin 2019 që  
11 ishte një aset serb. Pra, një mjet, le të themi, i shërbimeve  
12 të fshehta, mjet i paguar, pra, i shërbimeve të paguara serbe.

13 Pra, nocioni që ZPS-ja nuk ka nxjerrë informacione lidhur  
14 me këtë dhe nuk ka dalë nga shqyrtimi i rregullës 103, ka të  
15 bëjë me faktin që këto duhen gjykuar me shumë rëndësi, sidomos  
16 për dëshmitë për të cilat dëshmitarët nuk do të paraqiten para  
17 Gjykatës që të japin dëshminë e tyre personalisht.

18 Në përgjithësi, ne sugjerojmë se ka një sërë supozimesh  
19 që sa i takon - pra, ka një serë - më falni - indiciesh që  
20 Gjykata ka treguar qëndrimin e formuluar në mënyrë të  
21 kujdesshme që, në fakt, ka për qëllim që të mbrojë nga  
22 nxjerrja faktin që shqyrtimi i materialit shfajësues nga  
23 Prokuroria dhe ngurrimi që ka Prokuroria për t'ia dhënë këtë  
24 material Mbrojtjes është i kompromentuar. Sqarimi që është  
25 kërkuar është absolutisht i domosdoshëm duke pasur parasysh,

1 pikë së pari, faktin se nuk e kemi të qartë nëse materiali i  
2 kërkuar dhe i shqyrtuar është i rëndësishëm, sa është nxjerrë,  
3 sa mbetet për t'u nxjerrë.

4 Dhe po kështu, na duket e nevojshme lidhur me këtë që i  
5 nderuar Gjykatës të tregojë sa i takon prejardhjes së  
6 dokumenteve, pra, ato që vijnë nga na serbe, nga përvoja në të  
7 shkuarën, qoftë edhe një nëse kanë kaluar përmes procedimit të  
8 krimeve të luftës në Serbi, pra, kanë çuar në indicie të cilat  
9 tregojnë probleme sepse vetë për --

10 Unë do të thosha se Serbia është problem në vetvete  
11 lidhur me rregullin 103, pra, do të përbënte shkak pikërisht  
12 për ta quajtur një provë shfajësuese.

13 Pra, mendoj se ka jurisprudencë të bollshme në TPNJ  
14 lidhur me këtë, sa i takon marrjes parasysh të këtyre  
15 aspekteve kur bëhet vlerësimi i besueshmërisë së provave.  
16 Sidomos kur këto provave, sa i takon gjykimit të një çështje,  
17 vijnë nga Serbia. Bashkëpunimi i ZPS-së me një kriminel lufte  
18 të shpallur të tillë, pra, kriminel serb lufte të shpallur të  
19 tillë është shqetësuese. Të gjitha këto të çojnë në  
20 përfundimin se ajo që ka dalë në korrespondencën midis z.  
21 Kehoe dhe ZPS-së është një problem themelor që duhet zgjidhur.  
22 Dhe duhet zgjidhur tani dhe të mos lihet aty, sepse kjo ka të  
23 bëjë me detyrimet e nxjerrjes të cilat bien si barrë mbi ZPS-  
24 në.

25 Ky ishte parashtrimi im.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emerson.

2 Do t'i kërkojë ZPS-së që të përgjigjet më pas ekipeve të  
3 Mbrojtjes.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Po nuk e di nëse do të ndihmonte  
5 në këtë, së pari dua që të kërkoj një sqarim nga z. Emerson  
6 tani. Përndryshe dhe më vonë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, në fillim do t'ua jap  
8 fjalën të gjitha ekipeve. Nëse doni t'i përgjigjeni  
9 argumenteve të z. Kehoe sa i takon objektit të detyrimit të  
10 nxjerrjes dhe pastaj z. Emerson, pastaj dy pikat e tjera të  
11 z. Emerson që kanë të bëjnë, pra, me këtë. Nëse ju i keni  
12 nxjerrë gjithçka që keni shqyrtuar dhe objekti dhe koha e  
13 kërimit të synuar, kontrollit të synuar, pra, nëse e kam të  
14 saktë këtë.

15 z. Young, keni fjalën.

16 Z. YOUNG: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.  
17 Dua që në fillim ta bëj të qartë që ne mbështesim plotësisht  
18 parashtrimet e bëra nga z. Kehoe dhe z. Emerson.

19 Realitet është që raportet dhe artikujt në media sa i  
20 takon komplotit për t'i bërë atentat z. Marty duhet të përbëjë  
21 shqetësim për këtë Gjykatë dhe për ju vetë. Duke pasur  
22 parasysh që ky është individ i me influencë në krijimin e  
23 kësaj ndërtese është e lidhur drejtpërdrejtë me përfshirjen  
24 apo përpjekjet që bënë shërbimet e fshehta serbe që të  
25 implikojnë Kosovën në këtë atentat duhet të përbëj shqetësim.

1 Unë e them këtë se, i nderuar Gjykatës, duhet ta dijë  
2 mirë se detyrimi im themelor, më themelor i çdo gjykate është  
3 që të mbrojë procesin e vet nga abuzimi apo nga shpërdorimi,  
4 sepse, e thënë thjesht, gjykata duhet që të mbrojë  
5 integritetin e procedurave të tyre. Dhe nëse nuk e bëjnë këtë,  
6 atëherë këto procedura, me gjithë respektin që kam, nuk do të  
7 kishin vlerë.

8 Këto pretendime lidhur me z. Marty, që janë eksplozive,  
9 do të doja t'i vendosja në kontekst. Këto pretendime lidhur me  
10 z. Marty, siç e përmendi dhe z. Kehoe, nuk janë të izoluar,  
11 por, ne parashtrojmë se bëjnë pjesë e një modeli sjelljeje më  
12 në përgjithësi që përfshin këtu një bashkëpunim midis  
13 elementeve të shërbimeve sekrete serbe dhe ruse për të  
14 fajësuar në mënyrë të rreme UÇK-në kosovare dhe katër të  
15 akuzuarit.

16 Në këtë rast, ne mbështesim parashtrimet e z. Kehoe  
17 plotësisht sepse është e palejueshme që të mos mendohet se me  
18 këto prova, prejardhja e këtyre provave mund të mos prekë  
19 besueshmërinë e tyre. Prejardhja e provave është e rëndësishme  
20 dhe që *prima facie* bie në kategorinë rregullit 103.

21 Tri pika të shkurtra sa i takon kontekstit më të gjerë sa  
22 i takon kësaj narrative të rreme. Së pari, i nderuar Gjykatës,  
23 ka të bëjë me dhjetorin e vitit 1998, ku që atëherë presidenti  
24 u tha se agjent të shërbimit të sekret në Pejë të Kosovës, në  
25 masakrën në kafene Pandës, kanë vrarë gjashtë serbë në moshë



1 të re të Kosovës për t'ia vënë fajin në mënyrë të rreme UÇK-  
2 së.

3 Pastaj, pas disa ditësh, pas këtij incidenti tronditës me  
4 vdekje, me lëndime, vrasje, pra, një sërë shqiptarësh etnikë u  
5 arrestuan dhe u mbajtën të shoqëruar derisa u liruan.

6 Megjithëse Presidenti, mbas shumë vitesh e pranoi se ishin  
7 agjentët e tij ata, pra, agjentët e shërbimit të tij sekret që  
8 kishin përgjegjësi për këtë.

9 Pjesa e dytë e këtij konteksti që duhet mbajtur parasysh  
10 është historiku i pretendimeve të rreme serbe dhe ruse për  
11 trafikimin e organeve, sepse çdo analizë e përciptë e  
12 pretendimeve serbe dhe ruse e tregojnë shkoqur paralelizmin me  
13 raportin e z. Marty. Pretendimet ruse lidhur dhe me Ukrainën,  
14 pra, e bëjnë të qartë, pra, që pasqyrojnë pretendime krejt të  
15 ngjashme nga ana e shtetit rus.

16 Dhe raportet ruse në media kanë pretendime të rreme dhe  
17 dizinformacion sa i takon trafikimit të organeve nga ana e  
18 ukrainasve. Nuk janë këto raportet e izoluara. I nderuar  
19 Gjykatës mund të ketë vënë re se, në fakt, raportet në media  
20 sa i takon dizinformimit rus që pasqyron edhe pretendime të  
21 rreme në raportin e Marty vijnë nga viti 2014, 2017, 2019 dhe  
22 madje dhe në mars të këtij viti.

23 Pra, së fundi, e treta pikë. Kur i nderuar Gjykatës do të  
24 shqyrtojë parashtrimet tona dhe të ekipit të z. Thaçi lidhur  
25 me rregullin 103 - besoj se nuk është marrë ende një vendim sa

1 i takon kërkesave tona, sa i takon parashtrimin të z. Thaçi  
2 për një shqyrtim të pavarur të materialit shfajësues - ne ju  
3 parashtrijmë, me respektin e duhur, që duhet të mendoni me  
4 kujdes se arsyeja pse ndodhemi të gjithë këtu sot në këtë  
5 Gjykatë, në këtë proces, lidhet me një mocion për zgjidhjet që  
6 është parashtruar nga z. Kostantin Kosachev në Këshillin e  
7 Evropës. Pra, jo një mocion për vendim në këtë rast për një  
8 rezolutë "për trajtimin çnjerëzor të njerëzve dhe trafikimin e  
9 organeve njerëzore".

10 Pra, është një mocion, ka çuar pastaj në hetimin që ka  
11 bërë Dick Marty, ka çuar pastaj në raportin e Dick Marty dhe  
12 për rrjedhojë ka çuar në këtë Gjykatë. Një raport i mbështetur  
13 në një narrativë të rreme. Dhe në mënyrë alternative kur të  
14 shqyrtoni këto aspekte dhe mbase kjo u takon më shumë  
15 historianëve sesa avokatëve dhe gjykatësve, po të shikohet  
16 burimi i pretendimeve të rreme që i janë vënë në dispozicion  
17 z. Marty, të cilit i janë dhënë informacione nga Zyra e  
18 Prokurorisë së Carla Del Pontes që në vitin 2008.

19 Pra, ky është konteksti më i gjerë, që kërkon shqyrtim.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

21 Znj. Alagendra apo z. Ellis.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Shumë shkurt, mbi pikën e parë sa i  
23 takon provave që kanë prejardhje serbe, ne i mbështesim  
24 plotësisht parashtrimet e bëra nga të gjitha ekipet e  
25 Mbrojtjes sot.

1 Çështja sa i takon rregullit 103, i nderuar Gjykatës,  
2 është nëse ky është informacion i cili cenon besueshmërinë apo  
3 mbështetshmërinë e provave të ZPS-së. Dhe parashtrimi ynë,  
4 është se ajo që është thënë këtu sot, pra, që është një  
5 ndërhyrje e vazhdueshme serbe në incidente, siç është, për  
6 shembull, rasti i incidentit të kafene Pandës në vitin 1998  
7 apo dhe atentati i bërë kundër Dick Marty, që i mbështet shumë  
8 parashtrimet e bëra nga z. Kehoe, në emër të z. Thaçi, që ky  
9 material duhet nxjerrë. Dhe në momentin pasi të nxirret,  
10 pastaj duhen bërë dhe hapat e mëtejshme për ta hetuar.

11 E dyta që desha të them, i nderuar Gjykatës, ka të bëjë  
12 shumë me çështjen e kontrollit të synuar që ngriti z.  
13 Emmerson.

14 Qëndrimi i mbajtur në konferencën e fundit për ecurinë e  
15 çështjes është që Prokuroria shpjegoi se po bënin dy gjëra. Së  
16 pari një shqyrtim paraprak, pra, fillestar të provave dhe  
17 kontroll të synuar. Njëkohësisht, thanë ata, po bënin edhe  
18 kontrollin e synuar, për shembull, sa i takon listës së  
19 dëshmitarëve si një mënyrë për të siguruar të gjitha  
20 materialet shfajësuese të identifikoheshin dhe të nxirreshin.

21 Dhe ato vazhdonin të thoshin se kontrollet e synuara  
22 ishin një masë tjetër shtesë krahas shqyrtimit që ato bënin  
23 për të siguruar që këto informacione të nxirreshin. Ata nuk  
24 ishin në gjendje, herën e fundit, të jepnin një vlerësim të  
25 kohës që do të zgjaste ky shqyrtim, duke e thënë njëkohësisht

1 që kishin marrë me mijëra rezultate për një emër të vetëm dhe  
2 duheshin kontrolluar të gjitha këto.

3 Prandaj dhe për Mbrojtjen, kjo përbën shqetësim që vijmë  
4 tani në këtë konferencë për ecurinë e çështjes dhe Prokuroria  
5 parashton me shkrim kështu që ka kontrolle të synuara por --  
6 nuk e di nëse mund ta gjej, por ZPS-ja, duke pasqyruar dhe  
7 praktikën më të mirë të TPNJ-së edhe të GJPN-së, ZPS-ja këtu  
8 do të kryejë kontrolle të synuara gjatë gjithë procesit për të  
9 siguruar që edhe dëshmitarët që do të paraqiten këtu të kenë  
10 të identifikuar, të themi, të gjitha nxjerrjet sipas rregullit  
11 103.

12 Pra, duket se kjo do të ecte në mënyrë të njëkohshme që  
13 ato do të vazhdojnë dhe me dëshmitarët e ardhshëm. Sipas nesh,  
14 kjo nuk është e pranueshme. Kontrolle të synuara, për të cilat  
15 na është thënë herën e fundit që po kryheshin njëkohësisht me  
16 shqyrtimin fillestar, duhet të ishte ajo që duhet bërë sepse  
17 kontrollet e synuara duhet të identifikojnë. Janë gjëra që  
18 ZPS-ja i ka tani, jo gjëra që mund të dalin më pas. Janë gjëra  
19 të cilat ZPS-ja i ka në dorë ë tani edhe në konferencën e  
20 fundit për ecurinë e çështjes Prokuroria tha se mendonte se  
21 këto kontrolle mund të nxirrnin dokumente shtesë dhe prandaj  
22 ne kërkojmë që, i nderuari Gjykatës të vendosë një afat sot,  
23 brenda të cilit Prokuroria të përfundojë kontrollet e synuara  
24 përfshirë edhe ato që janë përmendur në konferencën e fundit  
25 për ecurinë e çështjes, në bazë të listës së dëshmitarëve të

1 ZPS-së.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim]

3 Faleminderit z. Ellis.

4 Z. Prokuror, për të gjitha çështjet, unë kam të paktën  
5 një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë. Çështja e objektit të  
6 detyrimit tuaj sipas Rregullës 103, që është ngritur nga të  
7 gjitha ekipet Mbrojtëse mendoj dhe çështja konkrete që ngriti  
8 z. Emmerson që jua rikujtova pak më pas, çështja e kontrolleve  
9 të synuara njëkohësisht me shqyrtimin fillestar apo më vonë  
10 dhe propozimi i z. Ellis për të vendosur një afat për  
11 kontrollet e synuara.

12 Keni fjalën.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

14 Do të fillojmë me sqarimet e z. Emmerson. Nuk ka ndonjë  
15 gjuhë të kujdesshme këtu kur themi që kemi mbaruar shqyrtimin  
16 fillestar, çdo gjë që ne kemi identifikuar që bie në rregullën  
17 103 ose është nxjerrë, ose do të nxirret brenda ditës së  
18 sotme. I vetmi përjashtim janë gjërat të cilat kanë të bëjnë  
19 me mocionet për masat mbrojtëse të cilat kemi thënë se do t'i  
20 parashtrojmë brenda fundit të muajit. Pra, shqyrtimi dhe  
21 nxjerrja, po ecin paralelisht.

22 Sa i takon kontrolleve të synuara, nuk ka një fazë të  
23 shqyrtimit fillestar dhe pastaj vjen kontrolli i synuar lidhur  
24 me ato që bëjmë ne. Kontroll të synuar po bëjmë tani, do të  
25 vijojnë edhe në të ardhmen, nuk kanë të bëjnë vetëm me

1 dëshmitarët. Kjo ka lidhje me vigjilencën, që ne të kujdesemi  
2 që në çdo moment të kemi identifikuar sa më shumë, pra të  
3 gjitha ato që është e mundur sa i takon rregullës 103.  
4 Prandaj edhe ne po bëjmë çmos që të bëjmë gjithçka si një  
5 garanci gjatë gjithë procesit. Por, për të gjithë materialin e  
6 shqyrtuar tashmë.

7 Të vetmet gjëra që nuk janë shqyrtuar, janë ato që unë i  
8 përmenda pak më përpara. Janë artikujt mbas janarit të këtij  
9 viti. Do ta mbarojmë shqyrtimin e kësaj muajin e ardhshëm dhe  
10 do të vazhdojmë ta bëjmë këtë shqyrtim dhe me materialet e  
11 reja kur të vijnë.

12 Sa i takon objektit të detyrimit së rregullës 103, ky  
13 është qëndrimi ynë lidhur me ato që tha z. Kehoe. Ne nuk  
14 mendojmë se çdo gjë që ka të bëjë me autoritetet serbe, bën  
15 pjesë në materialin e rregullës 103. Ekipet e ndryshme të  
16 Mbrojtjes vazhdimisht i bëjnë këto parashtrime në kontekste të  
17 ndryshme, qoftë edhe sa i takon artikujve në media për  
18 atentatin e z. Dick Marty dhe përfshirjen e shërbimeve serbe.

19 Në çështjen Gucati/Haradinaj, Trupi Gjykues numër 2 mori  
20 një mocion gjatë dy muajve të fundit, pikërisht lidhur me këtë  
21 gjë, me idenë për të hapur procesin për paraqitjen e provave.  
22 Në paragrafin 16 të vendimin KSC-BC-2020-07, F00610, këtë tha  
23 dhe Trupi Gjykues:

24 "Çështje të Raportuara kanë të bëjnë me pretendime të pa  
25 verifikuara të sjelljeve të paligjshme nga ana e autoriteteve

1 serbe, të cilat duken se s'kanë lidhje me bashkëpunimin e ZPS-  
2 së me këto autoritete...".

3 Mbase kanë ndonjë gjë më shumë në dorë ekipet e  
4 Mbrojtjes. Por, në vend që ta na çojnë neve email apo ta  
5 ngrenë këtë gjë të paparashikuar në rendin e ditës, mjafton që  
6 të na tregojë neve të gjithë bazën e tyre ligjore dhe faktike.  
7 Dhe ne do t'i përgjigjeshim siç duhet.

8 Ne mendojmë se kjo nuk përbën moskuptim nga ana jonë e  
9 objektit të detyrimeve që na lindin nga rregulla 103. Është  
10 thjeshtë një interpretim shumë i gjerë nga ana e Mbrojtjes  
11 lidhur me këtë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe,  
13 keni fjalën.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, më vjen keq që  
15 ZPS-ja mban këtë qëndrim. Ata janë shumë të ngushtë, punojnë  
16 shumë ngushtë me autoritetet serbe, sa i takon hetimit të  
17 kësaj çështje. Kanë shpallur një vend të lirë pune për zyrën e  
18 tyre në Beograd. Ku ka ndodhur kjo? Kanë zyrë në Beograd, por  
19 jo në Prishtinë.

20 Pesë dëshmitarë nga organet serbe i kanë marrë, të cilët  
21 synojnë t'i nxjerrin përpara Trupit Gjykses. Ka një mori  
22 dokumentesh të cilat padyshim vijnë nga raporti themelor i  
23 kësaj Gjykate, raporti i Dick Marty që është marrë parasysh  
24 nga Task Forca, pastaj ka ardhur këtu.

25 Avokatët e keqkuptuakan rregullën. Por në fakt kur

1 informacioni vjen nga një burim i pabesueshëm, po shoh  
2 rregullën 103, kjo mund të hidhte dyshime mbi besueshmërinë e  
3 provave të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Pra, kemi një  
4 burim dokumentesh që i vijnë ZPS-së, të cilat ZPS-ja i përdor  
5 në mënyrë rutinë. Që vijnë pra nga një burim që fabrikon  
6 prova, që sajton histori, që nxjerr parasysh lloj-lloj  
7 pretendimesh, për të mos përmendur ato që kanë të bëjnë me  
8 trafikimin e organeve të cilat nuk arritën të përfshihen në  
9 asnjë aktakuzë, që janë shumë të rëndësishme për këtë çështje  
10 gjyqësore.

11 Dallimi i madh midis kësaj çështje dhe çështjes tjetër të  
12 Haradinaj, që është çështje që ka të bëj me pengimin e  
13 drejtësisë. Por kjo këtu ka të bëjë me vitin 1997 dhe më  
14 përpara. Pra, kur autoritetet serbe nxjerrin këto dokumente të  
15 rreme, dëshmi të rreme, operacione që kërkonin të njollosnin  
16 palën kundërshtare. Pra, të gjitha këto do të duhet që të  
17 kishin ndaluar, por ja që nuk kanë ndaluar.

18 Ajo që ka ndodhur është që ne ende kemi edhe më shumë  
19 nxjerrje gjërash të tilla domethënë të pakëndshme. Kur faji  
20 për atentatin ndaj një personi që është përgjegjës për  
21 ngritjen e kësaj gjykate, është që t'ia ngjisin autoriteteve  
22 serbe [sipas përkthimit]. Të paktën kjo është sipas raporteve  
23 të shërbimeve të fshehta serbe [sipas përkthimit]. Pra, të  
24 fajësoheshin kosovarët. Mbase mund të merrej Dick Marty si  
25 dëshmitar për të sqaruar të gjithë këtë.



1           Është e paimagjinueshme që dokumentet të cilat vijnë nga  
2 burime serbe, duke pasur parasysh edhe pretendimet e rreme që  
3 janë parë tashmë, përshirë këtu edhe trafikimin e organeve  
4 njerëzore.

5           Ose ta themi ndryshe: duke pasur parasysh gjithçka që  
6 dimë ne se çfarë po bënin autoritetet serbe, si mundet që  
7 dokumentet që ZPS-ja i ka marrë dhe i ka përdorur, nuk e  
8 cenojnë besueshmërinë e çështjes së ZPS-së, e provave të ZPS-  
9 së, nëse këto dokumente kanë ardhur nga autoritete shtetërore  
10 serbe.

11           Nuk dua shumë që të përsëris ato që kam thënë. Unë do  
12 ulem. Por besoj që ju kuptoni që unë po përpiqem që të arrij  
13 që ZPS-ja të përmbushë detyrimin e vet lidhur me këtë rregull.

14           Z. HALLING: [Përkthim] Përpara se z. Kehoe të marrë  
15 përsëri fjalën, për të korrigjuar. Ne nuk kemi zyrë, ZPS-ja  
16 nuk ka zyrë në Beograd. Desha ta korrigjoj këtë fakt.

17           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim]  
18 Faleminderit.

19           Z. Emerson.

20           Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Shumë  
21 shkurt, nëse mundem.

22           Ajo që dua të them është dëshira për të zgjidhur këtë  
23 mospërputhje qëndrimesh midis ZPS-së dhe Mbrojtjes.

24           Shumë qartë, nëse mund ta them, është një argument i  
25 dobët që paraqitet këtu, se çështjet që janë paraqitur para

1 Trupit Gjykues në çështjen Haradinaj [sipas përkthimit] lidhur  
2 dhe me atentatin kundër Dick Marty, mund të vlenin edhe në  
3 rastin tonë sa i takon vendimit që ka marrë Trupi Gjykues në  
4 atë çështje. Arsyet pse Trupi Gjykues i mori atëherë, arsyet  
5 pse u mor ky vendim nga Trupi Gjykues në ato çështje, ishte që  
6 ky s'kishte lidhje drejtpërdrejtë me bashkëpunimin.

7 Por ne këtu themi, që gjithçka që lidhet me këtë  
8 bashkëpunim duhet që t'i nxirret Mbrojtjes. Të paktën të  
9 thuhet nëse ka pasur bashkëpunim. Dhe nëse po, cilat kanë qenë  
10 hollësitë e këtij bashkëpunimi.

11 Është e vetëkuptueshme, plus që është provuar tashmë nga  
12 TPNJ-ja, që nëse një dëshmitar paraqitet që të japë dëshmi  
13 lidhur me këtë konflikt, fakti se asokohe kanë qenë qoftë  
14 zyrtarisht apo jozyrtarisht bashkëpunëtorë apo të lidhur me  
15 shtetin serb apo me njësitë e këtij shteti në terren, është me  
16 rëndësi jo vetëm për nxjerrjen. Sepse Prokuroria në TPNJ këtë  
17 e bënte rutinë, pra që ishte rutine kjo nxjerrje. Por kur  
18 Trupi Gjykues pastaj mendon se çfarë rëndësie t'i japë kësaj  
19 prove që vijnë nga këto burime.

20 Edhe pse ka shumë prova si në të shkuarën, po disa prej  
21 materialeve në këtë çështje ka pasur manipulim dhe korrupsion  
22 nga elementë të caktuar të aparatit serb, përfshirë edhe Zyrën  
23 e Prokurorisë të Krimeve të Luftës, përmes së cilës pastaj i  
24 janë kaluar Prokurorisë këtu.

25 Por s'ka nevojë që të shkojmë aq larg, është e

1 vetëkuptueshme që çdo gjë që rrjedh që vjen nga Serbia, në  
2 kuadër të konfliktit midis Serbisë dhe Kosovës apo midis UÇK-  
3 së dhe forcave serbe, vjen pra nga burimet e tyre, është nga  
4 një burim i papastër në këtë rast.

5 Dhe nëse Prokuroria nuk i ka këto, nëse nuk i ka  
6 përmbushur këto detyrime të nxjerrjes në këtë bazë deri tani,  
7 atëherë është një problem urgjent dhe shumë i rëndë. Sepse,  
8 nëse ato i kanë interpretuar gabim detyrimet e tyre, nuk ka  
9 mundësi që Trupi Gjykses do ta lejojë procedimin deri në fund  
10 në bazë të dëshmitarëve të cilët janë sajuar apo nxitur nga  
11 autoritetet serbe që të japin dëshminë, pa u nxjerrë kjo  
12 Mbrojtjes.

13 Herët a vonë, do të bëhet e nxjerrshme. Por, atëherë  
14 Prokuroria do të ketë kryer procesin e nxjerrjes siç e ka bërë  
15 deri tani, pa u mbështetur në këtë detyrim. Është e vështirë  
16 për ne ta kuptojmë pse e mban këtë qëndrim. Sepse kjo do të  
17 tregojë, do të nxjerrë objektin dhe kjo është e qartë, se sa  
18 shumë ZPS-ja është mbështetur në burime të papastra të cilat  
19 vijnë nga Serbia.

20 Mund t'i bëjmë vetes pyetjen: pse apo çfarë përpiqet të  
21 fshehë Prokuroria, shkallën deri ku ajo mbështetet në burime  
22 të korruptuara brenda Serbisë? Kjo nuk do të ishte një  
23 Prokurori e përgjegjshme. Por, mund të argumentoj edhe  
24 ndryshe, sigurisht nëse ato argumentojnë që nuk do kishte  
25 lidhje, atëherë është tjetër.

1 Ne mund të bëjmë pyetjen, pse Prokuroria ndjek pikërisht  
2 këtë qëndrim, mban këtë qëndrim të pajustificueshëm për të mos  
3 treguar shkallën se deri ku po diskutohet mbi një burim të  
4 njëanshëm? Jo vetëm përmes operacioneve që njollosin palën  
5 kundërshtare që kanë karakterizuar konfliktin në fjalë, por  
6 edhe vetë pretendimi për trafikim të organeve, nuk dua të  
7 përsëris se çfarë është thënë deri tani, por i vetmi dëshmitar  
8 që ka dëshmuar për heqjen e paligjshme të organeve, marrjen e  
9 paligjshme të organeve, është dëshmitari që unë e përmenda më  
10 përpara, që më pas e pranoi që ishte gënjeshtër dhe se e  
11 kishin detyruar shërbimet e fshehta serbe që të thoshte  
12 kështu. Dhe mbasi u mor vesh, ndodhi një gjë tjetër.

13 Gjithsesi, shkalla në të cilën është bashkëpunuar me  
14 autoritetet serbe, ka qenë shumë e madhe. Shumë e madhe. Dhe  
15 nocioni që Prokuroria përpiqet që ta mbajë këtë të larguar  
16 nga, pra mos t'ia tregojnë, më saktë, palëve, të akuzuarve dhe  
17 ekipeve të Mbrojtjes se si kanë bashkëpunuar me serbet, është  
18 tronditëse dhe duhet zgjidhur menjëherë.

19 Ne i kërkojmë të nderuarit Gjykatës, që të japë urdhër që  
20 të na tregohet burimi. Kur vjen një provë nga një burim  
21 shtetëror serb, mjafton ky fakt që të tregojë se ka të bëjë me  
22 besueshmërinë, sepse ky është një burim i njëanshëm në një  
23 konflikt. Mjafton që të vijë nga një burim i një pale në një  
24 konflikt, në vetvete kjo do ta bënte të nxjerrshëm burimin.

25 Serbia vazhdon që të bëjë një fushatë politike në çdo

1 fushë për të mposhtur statusin e pavarësisë së Kosovës dhe  
2 shkalla dhe mënyra me të cilën ato kanë bashkëpunuar me ZPS-në  
3 në këtë proces, është padyshim shumë e ndikuar nga qëndrimet  
4 politike që ka mbajtur Serbia. Pra, ata e kanë treguar që nuk  
5 janë larg manipulimeve, nuk e kanë për gjë që të manipulojnë  
6 informacionet. Edhe sa i takon planit për t'i bërë atentat  
7 Dick Marty, është një shembull i rëndë i operacioneve serbe  
8 për t'ia hedhur fajin palës tjetër. Kjo ka të bëjë me themelin  
9 e këtij tribunali, se i gjithë ky tribunal është ngritur  
10 pikërisht mbi këtë bazë, në bazë të pretendimeve të raporteve  
11 të Dick Marty.

12 Ne e dimë që këto pretendime kanë ardhur nga Serbia dhe  
13 janë të fabrikuara. Siç e tha dhe z. Kehoe, nuk ka asnjë  
14 pretendim apo aktakuzë të ngritur nga ZPS-ja që të ketë të  
15 përfshirë edhe marrjen e paligjshme të organeve njerëzore.  
16 Sepse dihet tashmë që shërbimet e fshehta serbe janë përpjekur  
17 që me informacionet e tyre të çojnë në këto lloj pretendimesh.

18 Ne mendojmë që çdo dokument dhe informacion që është me  
19 burim serb, është i nxjerrshëm. Ne e kemi të vështirë ta  
20 kuptojmë qëndrimin e mbajtur nga Prokuroria. Ju si Gjykatës  
21 mund të merrni vendim qoftë edhe në bazë të argumentit që  
22 është një burim i njëanshëm i një pale që ka marrë pjesë në  
23 konflikt.

24 Nëse ju mendoni se kjo nuk është e përshtatshme, atëherë  
25 s'ka më kuptim që palët të diskutojnë më tej mes tyre, sepse

1 Prokuroria po e bën procesin vetë mbi baza të rreme. Nëse ju  
2 nuk jeni në gjendje që të bëni të ditur sot sa i takon  
3 procesit të nxjerrjes që duhet bërë në kohën e duhur, atëherë  
4 do të kemi një afat shumë të shkurtër për parashtrimet me  
5 shkrim lidhur me këtë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim]

7 Faleminderit, z. Emmerson.

8 Z. Young.

9 Z. YOUNG: [Përkthim] Asgjë për të shtuar.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis?

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Asgjë për të shtuar.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Prokuror,

13 doni të shtoni diçka? Jo? Faleminderit shumë.

14 Për këtë temë, ftoj palët të paraqesin parashtrimet me  
15 shkrim për këtë temë, duke pasur parasysh se do t'i jap  
16 përparësi kësaj çështjeje. Ftoj gjithashtu Mbrojtjen që ta  
17 mbështesin me prova kërkesën e tyre dhe Prokuroria gjithashtu  
18 të përgatisë argumentet e veta.

19 Gjithashtu ftoj palët që të kenë parasysh jurisprudencën  
20 aktuale të tribunaleve ndërkombëtare dhe të kenë parasysh  
21 çështjen e hetimeve të përbashkëta me ekipet e vendeve të  
22 tjera.

23 Tani, të kalojmë tek materialet e rregullës 103.

24 U kujtoj palëve se në konferencën e mbajtur më 29 tetor  
25 2021, e pezullova afatin e Mbrojtjes për materialet 102(3).

1 Që nga konferenca e fundit, ZPS-ja vuri në dukje se ka  
2 nxjerrë më shumë se 14.000 dokumente dhe se paketa të tjera  
3 janë duke u përgatitur. Gjithashtu paralajmëroj se sfidat për  
4 rëndësinë materiale dhe kërkesa për redaktime, do të jenë të  
5 nevojshme lidhur me disa kërkesa në bazë të rregullës 102(3)  
6 në të ardhmen e afërt.

7 E ftoj ZPS-në të na tregojë se kur planifikon të bëjë  
8 parashtrime të tilla. ZPS-ja vlerëson se do të mund të  
9 trajtojë 40.000 kërkesa të tjera, nga tani deri në 22 korrik  
10 2022. Megjithatë, ZPS-ja nuk mendon se materialet e Rregullës  
11 102(3) është një fushë ku mund të përcaktohet procesi i  
12 nxjerrjes së materialeve para gjyqit, prandaj e kundërshton  
13 afatin 22 korrik 2022 si afat për shqyrtimin e ZPS-së të kësaj  
14 kategorie materiali prove.

15 ZPS-ja shpjegon se të paktën një ekip i Mbrojtjes tani ka  
16 kërkuar pothuajse 97 për qind të materialeve, në bazë të  
17 njoftimit të rregullës 102(3), duke krijuar për të detyrim  
18 mjaft të rëndë për nxjerrje materiale.

19 Sipas ZPS-së, përfundimi i plotë i nxjerrjes së  
20 materialeve nuk duhet të shërbejë si një afat procedural për  
21 të transferuar çështjen përpara Trupit Gjykses dhe procesi i  
22 nxjerrjes së materialeve do të vazhdojë deri në fazën kur do  
23 të fillojë gjykimi.

24 Të jemi të qartë. I kujtoj ZPS-së dhe më parë urdhërova  
25 një kalendar procedural sipas të cilit të gjitha materialet e

1 rregullës 102(3) që duhet të nxirreshin, duhet të përfundonin  
2 përpara se sa ajo të paraqesë dosjen e saj paragjyqësore. ZPS-  
3 ja nuk ngriti ndonjë kundërshtim në atë kohë për këtë gjë.

4 Gjithashtu, i kujtoj ZPS-së se në të gjitha rastet e  
5 tjera përpara DS-së, sistematikisht kam urdhëruar nxjerrjen e  
6 materialeve të Rregullës 102(3) e cila duhet të përfundojë  
7 gjatë fazës paraprake me qëllim që, së pari, t'i lejojë  
8 mbrojtjes të përgatisë çështjen e saj përpara fillimit të  
9 gjykimit; dhe së dyti, të mos e lejojë Trupin Gjykses të  
10 detyrohet që t'i ndërpresë procedurat për t'i lejuar Mbrojtjes  
11 të kryejnë hetime specifike të lidhura me nxjerrjen e vonuar  
12 të materialit provë, që sigurisht do të vononte procesin  
13 përpara çdo Trupi Gjykses.

14 Rrjedhimisht, ftoj ZPS-në të na thotë se përse tani  
15 mendon se nxjerrja duhet të vazhdojë edhe gjatë fazës së  
16 gjykimit. Dhe përse nuk është në gjendje të plotësojë  
17 detyrimet e saj të nxjerrjes deri më 22 korrik 2022, sikundër  
18 ishte propozuar në Urdhrin e Punës më përpara.

19 Mbrojtja vazhdon të jetë e shqetësuar nga koha që ZPS-ja  
20 po përdor për të plotësuar detyrimet e saj të rregullës 102(3)  
21 dhe ngarkesën e madhe që është krijuar të materialeve që duhen  
22 bërë të njohura. Prandaj Mbrojtja mbështet vendosjen e një  
23 afati përfundimtar 22 korrik 2022, deri kur ZPS-ja të ketë  
24 përfunduar shqyrtimin e kërkesave të Mbrojtjes, kryesisht  
25 sepse njoftimi i rregullës 102(3) është paraqitur pothuaj 10



1 muaj më parë. Pa një afat të përcaktuar, ka gjasa që të  
2 vazhdojë nxjerrja e materialeve sipas rregullës 102(3) pa  
3 fund. Vonesat në nxjerrjen e materialeve të rregullës 102(3),  
4 ndikojnë drejtpërdrejtë në përgatitjen e Mbrojtjes për  
5 çështjen e saj dhe në përgjithësi për ecurinë e çështjes drejt  
6 gjykimit.

7 Gjithashtu, Mbrojtja vë në dukje se synon të bëjë kërkesa  
8 të tjera të synuara në të ardhmen.

9 Prandaj, ndërsa Mbrojtja e Veselit është e gatshme të  
10 angazhohet ndaj afatit 22 qershor 2022 për të parashtruar  
11 kërkesat e saj të mëtejshme, Mbrojtja e Thaçit dhe e Krasniqit  
12 nuk e mbështesin rivendosjen e afateve për kërkesat e tyre të  
13 rregullës 102(3).

14 I informoj palët se synoj që të vendos një afat për  
15 nxjerrjen e materialeve të rregullës 102(3), që është kërkuar  
16 ndërkohë nga Mbrojtja, sipas rregullës 95(2). Ftoj ZPS-së të  
17 bëjë parashtrime të hollësishme lidhur me kohën që i nevojitet  
18 për shqyrtimin dhe nxjerrjen e dokumenteve të kërkuara tashmë  
19 nga Mbrojtja.

20 Z. Prokuror, keni fjalën.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

22 Për sa i takon çështjes që ngritët se kur do t'i bëjmë  
23 parashtrimet për materialet e rregullës 102(3) që kërkojnë  
24 masa mbajtëse, nuk kemi ndonjë datë konkrete në mendje. Donim  
25 ta bënim pas mocionit 103 që menduam se ishte më urgjent, siç

1 na kërkuat.

2 Për sa i takon kalendarit dhe praktikës së çështjeve të  
3 tjera të cilat i vutë në dukje dhe kohën e detyrimeve tona,  
4 kërkohen disa shpjegime.

5 Parashtrimet tona me shkrim kanë përcaktuar një vlerësim  
6 agresiv por të mundshëm, mendojmë ne, për nxjerrjen e  
7 materialeve në bazë të 102(3). Në konferencën e 11-të ne thamë  
8 që kemi bërë 8000 nxjerrje materialesh. Në këtë konferencë  
9 janë bërë 14.000. Tani propozojmë të nxjerrim edhe 40.000 të  
10 tjera.

11 Pra, po e marrim seriozisht detyrimin tonë. Ka një kufi  
12 sa mund të bëjë njeriu dhe sa burime mund të përdoren dhe  
13 duhet ta theksonim këtë. Së pari, përse na duhej kaq shumë  
14 kohë sa ç'kemi marrë. Mbrojtja e lidh kohëzgjatjen e procesit  
15 të nxjerrjeve të materialit, me kohëzgjatjen e ndalimit të të  
16 akuzuarve dhe argumentojmë se nxjerrja është e papërshtatshme  
17 për shkak të numrit të madh të redaktimeve të bëra.

18 Të gjitha këto konsiderata janë të lidhura me njëra-  
19 tjetrën. Ne mund të nxjerrim të gjithë përmbajtjen e  
20 materialeve të 102(3) sot me një shtypje butoni, në qoftë se  
21 nxjerrja e plotë do të ishte e vetmja gjë që na shqetëson.  
22 Por, procesi i nxjerrjes kërkon rishikime, kontrolle,  
23 redaktime, përpunime me qëllim që të sigurohemi që njerëzit të  
24 mbrohëm. Dhe e kemi thënë vazhdimisht nevojën e masave  
25 mbrojtëse, të cilat lidhen me klimën e frikësimit të

1 dëshmitarëve në Kosovë, që krijon edhe problemet, rreziqet që  
2 kemi vënë në dukje.

3 Kjo klimë vazhdon, sikur është treguar qartësisht nga  
4 konstatimet në gjykimin këtë të mërkurë të çështjes Haradinaj  
5 dhe Gucati.

6 Por, ajo që Mbrojtja kërkon në parashtrimet e saj dhe ne  
7 e vlerësojmë që ju i keni dhënë urdhra të tilla më parë, por  
8 në këtë rast nxjerrja kërkohet në një kohë të paarsyeshme duke  
9 pasur parasysh shkallën e çështjes. Sepse ata hedhin poshtë  
10 nevojën e masave mbrojtëse që janë urdhëruar.

11 Me që po diskutojmë, dhe kjo lidhet mbi parashtrimin e  
12 Mbrojtjes së Veselit, letra jonë nuk tha që ne i pajtojmë  
13 masat mbrojtëse pa i shqyrtuar. Ne kemi thënë, ne jemi gati të  
14 pranojmë masa mbrojtëse të nevojshme.

15 Pika e dytë që duam të theksojmë në këtë drejtim është  
16 se, ne nuk po themi se rregulli 102(3) nuk është i  
17 rëndësishëm, por po themi se ekipet po keqinterpretojnë,  
18 paraqesin rëndësinë e këtij njoftimi për përgatitjet e tyre.

19 Mbrojtja e Krasniqit e bën qartë këtë në parashtrimet e  
20 veta. Në paragrafin 7(a) të materialit F00807, thuhet:

21 "Sigurisht, Mbrojtjes duhet t'i jepet një mundësi e  
22 barabartë që të shqyrtojë materialet e nxjerra në bazë të  
23 rregullës 102(3), që janë materiale të nevojshme për  
24 përgatitjen e Mbrojtjes dhe për kryerjen e hetimeve përpara se  
25 të fillojë gjyqi".

1 Kjo nuk është e vërtetë. Materialet e rregullës 102(3),  
2 nuk janë materiale të rëndësishme për përgatitjen e Mbrojtjes.  
3 Sipas përkufizimit, ato janë relevante për çështjen. Por,  
4 është një standard më i ulët dhe është një standard mjaft i  
5 gjerë mbas udhëzimeve që keni dhënë ju në këtë çështje dhe në  
6 çështje të tjera dhe që i ka miratuar dhe Gjykata e Apelit.  
7 Kjo do të thotë se ekipet e Mbrojtjes gjithmonë zgjedhin  
8 dokumente që nuk kanë gjasa të jenë me rëndësi materiale për  
9 përgatitjen e tyre. Megjithatë jua kemi nxjerrë, sepse është  
10 më e shpejtë ta bësh këtë se sa t'i kundërshtosh.

11 Por, çdo pritshmëri se zgjedhjet në bazë të rregullit  
12 102(3) do të ishin selektive, gjë që mbase është menduar të  
13 bëhej në fazën paraprake, në fakt nuk është bërë e mundur në  
14 praktikë. Këtë mund ta shikoni me disa shembuj.

15 SITF0041896 [sipas përkthimit] është një nga seritë prej  
16 15 raporteve të zgjedhur të KFOR-it që përshkruajnë qartë atë  
17 që ka ndodhur në kazernat e KFOR-it.

18 Një tjetër intervistë e zgjedhur nga tre ekipet e  
19 Mbrojtjes, e bën të qartë se ishte nxjerrë sipas rregullës  
20 102(1) (b) .

21 SPOE0010708 [sipas përkthimit] është një foto e nxjerrë e  
22 një grope të gërmuar si pjesë e provave materiale të bëra të  
23 njohura më përpara, megjithëse përshkrimi thotë qartë se është  
24 foto e një salamandre në një gropë të gërmuar.

25 Mbrojtja, sigurisht, ka të drejtë të zgjedhë çfarëdo

1 materiali që dëshiron nga rregulla 102(3). Dhe ne do t'ia  
2 japim, do t'ia bëjmë të njohura sa më shpejt të mundemi. Dhe e  
3 kemi thënë dhe në parashtrimet tona që synojmë ta shpejtojmë  
4 procesin.

5 Ju pyetët se kur këto dokumente të zgjedhura mund të  
6 përfundojnë. Nuk jemi në gjendje të japim një vlerësim të  
7 besueshëm për shkak se kapacitetet tona nuk i kemi, por kur të  
8 përfundojë ky rishikim, do të rriten. Dhe ne kemi thënë që do  
9 të bëjmë shumë më tepër deri më 22 korrik, që keni vënë ju në  
10 dukje.

11 Dëshëm të theksonim se ajo që parashtron Mbrojtja si  
12 kushte për përgatitjen e dosjes paraprake, nuk janë kushte  
13 reale. Janë një listë me dëshira që nuk ka lidhje me skemën  
14 ligjore. Dhe këtë mund ta shikoni shumë qartë në parashtrimin  
15 e Mbrojtjes së z. Veseli, kur ata duan të dinë gjatë 6 muajve  
16 përpara çdo gjë që lidhet me dëshmitarët e ZPS-së, përpara se  
17 të përgatisin dosjen paraprake.

18 Kushti i rregullës 102(3) është diçka që ata e duan, por  
19 jo se kanë nevojë për të përgatitur dosje paraprake, apo duke  
20 pasur parasysh rregullin 102(4), ta transferojnë çështjen, ta  
21 paraqesin çështjen përpara Trupit Gjykses.

22 Ajo që Mbrojtja ka nevojë më shumë e kanë dhe pjesa  
23 tjetër do t'ju vijë pjesë-pjesë në formë të përsheptuar.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Z. Kehoe.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Kur Prokurori ngrihet dhe paraqet  
3 një argument të tillë, mund të quhet vetëm alarmues. Asgjë nga  
4 këto që tha nuk janë të vërteta.

5 Rregulla kërkon që nxjerrja e materialeve që mendohen,  
6 gjykohen nga Mbrojtja se kanë rëndësi për përgatitjen e saj.

7 Prokurori ngrihet përpara Jush, thua sikur i kanë  
8 përmbushur të gjitha afatet, janë përmbushur të gjithë urdhrat  
9 tuaja, se kanë vepruar në kohën e duhur. Ju qeshni, sepse  
10 është qesharake kjo që thonë. Është qesharake që të çohet  
11 përpara jush Prokurori dhe thotë, "Po, i kemi respektuar të  
12 gjitha detyrimet për të nxjerrë materialet". Dhe e vë në dukje  
13 faktin, dhe këtë e shkrova, se nxjerrja e materialeve është  
14 kyç, lidhet në formë shumë të rëndësishme me paraburgimin. Dhe  
15 është e vërtetë që klienti im dhe 3 zotërinjtë e tjerë, janë  
16 këtu që nga nëntori i 2020-s dhe duan që kjo çështje të eci  
17 shpejt drejt gjykimit.

18 Por, është një fakt i vogël që Prokurori e harroi. Kur  
19 kjo çështje u paraqit përpara jush në vjeshtën e 2020, ZPS-ja  
20 ju tha pa ju dridhur qerpiku, se çështja do të shkonte në gjyq  
21 në pranverën e 2021. Para një viti. Një vit më parë. Dhe thanë  
22 se do të ishin të gatshëm të fillonte gjyqi. E megjithatë nuk  
23 i kanë përmbushur detyrimet e nxjerrjes së materialeve. Nuk e  
24 kanë përfunduar ende nxjerrjen e materialeve të 103. As nuk i  
25 janë afruar, madje, plotësimin të këtyre detyrimeve.

1 Dhe komentit i Prokurorit që thotë që, kjo s'ka të bëjë me  
2 dosjen paraprake. Jam shumë i kënaqur që ai futet në kokën  
3 tonë dhe e merr vendimin për ne. Por, ju e thatë shumë qartë,  
4 i nderuar Gjykatës në procedurën e fundit që patëm, se kur  
5 Mbrojtja nuk i ka marrë të gjitha materialet, është e vështirë  
6 që Mbrojtja të bjerë dakord për faktet.

7 Ne nuk kemi marrë një pjesë të madhe të materialeve, pra  
8 të gjitha këto lidhen me njëra-tjetrën. Nxjerrja e  
9 materialeve, ajo që mund të biem dakord për faktet, nxjerrja  
10 që ka të bëjë me çështje që janë redaktuar. Të gjitha janë të  
11 lidhura me njëra-tjetrën. Por, të dali Prokurori përpara jush  
12 mbas pothuaj dy vitesh pasi zotërinjtë janë futur në burg,  
13 ndërkohë që s'i kanë përmbushur detyrimet e tyre, kjo është me  
14 të vërtetë të le pa frymë, pa fjalë.

15 Ne kemi nevojë për këto dokumente. Ne kemi bërë kërkesë.  
16 Nuk e bëmë kështu se na u tek, pa e menduar. Ekipi im nuk ka  
17 kohë të bëjë gjëra që nuk i duhet të bëjë.

18 Pra, Prokurori duhet të urdhërohet që ta bëjë punën e  
19 vet, që çështja të ecë përpara dhe të vejë në gjyq dhe t'i  
20 lëri këto budallallëqet që paraqet se i ka plotësuar të gjitha  
21 urdhrat tuaja, ndërkohë ka kaluar më shumë se një vit nga koha  
22 që kishim parashikuar ta bënin. Prandaj ju drejtohem ju, që  
23 të na jepni udhëzime se si të vazhdojmë, që ta çojmë këtë  
24 çështje në gjyq.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Z.

1 Emmerson.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Do të  
3 trajtoj çështjen e renditjes së dëshmitarëve që do të thirren  
4 gjatë 6 muajve të parë të gjyqit. Ka një pikë në program që ka  
5 të bëj me datën për paraqitjen e dosjes paraprake të Mbrojtjes  
6 dhe çështjes së thjeshtimit. Pastaj do të lë znj. O'Reilly të  
7 flasë për çështjet e tjera të mbetura të nxjerrjes së  
8 materialeve.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Znj.  
10 O'Reilly.

11 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Faleminderit. Kam disa çështje  
12 për të ngritur në përgjigje të asaj që tha z. Halling.

13 Ai përmendi që kemi kërkuar dokumente që janë nxjerrë. Po  
14 prandaj e kam kërkuar gjithmonë që dokumentet të kenë numra  
15 dhe kros-referenca që ne ta dimë dhe me qëllim që t'i heqim  
16 nga lista kur i kërkojmë.

17 Salamandrën nuk e futëm ne në listë, ZPS-ja e futi. Është  
18 mënyra se si ata e trajtojnë këtë ushtrim edhe kështu  
19 ngatërrohet edhe salamandra. Në qoftë se duan të kundërshtojnë  
20 rëndësinë materiale të këtij materiali, ata mund ta bëjnë dhe  
21 ne do t'i përgjigjemi. Por, këto probleme i ka krijuar ZPS-ja  
22 dhe jo ne.

23 Dhe së fundi, ata nuk kanë thënë se kur do të jenë në  
24 gjendje të respektojnë detyrimin e tyre të nxjerrjes së  
25 materialeve që kemi kërkuar. Nuk e di nëse mund të marrim



1 përgjigje më konkrete lidhur me parashtrimet tona.

2 Kaq kam për momentin, i nderuar Gjykatës. Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] As unë  
4 s'kam harruar.

5 Z. Young.

6 Z. YOUNG: [Përkthim] Faleminderit. Dy pika të shkurtra.

7 Së pari, lidhur kur ZPS-ja duhet t'i nxjerrë materialet e  
8 rregullës 102(3). Siç e kuptoj unë, Ju e bëtë të qartë se  
9 qasja juaj në raste të tjera ka qenë që të sigurojë që  
10 materialet e rregullës 102(3) të trajtohen në fazën paraprake  
11 që Mbrojtja të mund të përgatitet, që është një qasje e  
12 logjikshme. Nuk ka kuptim për ne që t'i marrim gjatë apo pas  
13 gjyqit. Pra, këto gjëra bëhen në fazën paragjyqësore.

14 Së dyti. Në lidhje me rëndësinë materiale, ju mund ta  
15 keni vënë re në parashtrimet me shkrim tona se Prokuroria s'po  
16 thotë që në të ardhmen mund të vërë në dukje disa kundërshtime  
17 lidhur me rëndësinë materiale. Përse e thotë tani? Ju e dini  
18 shumë mirë se gjatë disa konferencave unë kam ngritur  
19 rregullisht faktin që nuk është vënë në dukje, as edhe një ide  
20 nuk është dhënë se do të ishte në kundërshtim me rëndësinë  
21 materiale. Tani më mungojnë 42.000 dokumente dhe tani ata  
22 thonë që do të kundërshtojmë aspektin e rëndësisë materiale.

23 Përse nuk u vu Gjykata në dijeni përpara? Dhe ky problem  
24 mund të ishte trajtuar shumë më herët, ndërkohë që po humbasim  
25 shumë kohë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim]

2 Faleminderit z. Young.

3 Z. Ellis.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Do të përpiqem të flas shkurt, duke  
5 pas parasysh kohën. Por dua të them se nuk pranoj në asnjë  
6 çast se parashtrimet tona kanë qenë të pavërteta.

7 Në qoftë se diskutohet se materialet e rregullës 102(3),  
8 sipas përkufizimit, janë me rëndësi për Mbrojtjen, ne e kemi  
9 marrë këtë formulim vetë nga teksti i rregullës 102(3). Pra,  
10 për asnjë moment nuk e pranoj që ky parashtrim është i  
11 pavërtetë.

12 E dyta, është ajo që e ngriti znj. O'Reilly, se në fund  
13 të ditës Prokuroria i futi këto në listë, duke thënë duke  
14 menduar se ishin me rëndësi. Ne në disa konferenca për ecurinë  
15 e çështjes, e ka vënë në dukje edhe Mbrojtja e Selimit, kemi  
16 kërkuar se çfarë test relevance është përdorur. Për mua është  
17 Prokuroria ajo që e ka hartuar këtë listë dhe ka thënë që e  
18 kanë kaluar testin e relevancës.

19 Ne vazhdojmë të gjejmë se, dokumente të futura përpara  
20 në listën e rregullës 102(3) dalin befas në listën e rregullës  
21 103 që ka të bëjë me nxjerrjen e materialeve. Pra, Prokuroria  
22 e ka ditur që kanë qenë materiale shfajësuese.

23 Janë 12 dokumente një grup tjetër materialesh shfajësuese  
24 në bazë të rregullës 102(3). Dokumente që dalin në paketat  
25 shfajësuese 234, 242, 243, 247, 248, 252 edhe sot.

1 Kur Prokuroria ngrihet dhe thotë që ato që na kanë  
2 kërkuar nuk janë materiale me rendësi, në fakt secili prej  
3 këtyre paketave që janë nxjerrë, ishin jo vetëm me rëndësi për  
4 përgatitjen e Mbrojtjes, por ishin në fakt shfajësuese.

5 E fundit që dua të sqaroj. Dua të sqaroj qëndrimin e  
6 Mbrojtjes së Krasniqit. Unë u ngrita në konferencën e fundit  
7 dhe parashikova se do të kemi dy kërkesa të tjera në bazë të  
8 Rregullës 102(3). E kemi bërë siç thashë. Siç janë punët, ne  
9 kemi përfunduar. Nuk propozojmë të bëjmë ndonjë kërkesë tjetër  
10 mbas rregullit 102(3) po të mos dalë ndonjë gjë tjetër e  
11 paparashikueshme mbi ecurinë e çështjes. E mbështesim  
12 plotësisht propozimin e Mbrojtjes së Veselit që të vendoset  
13 një afat për Prokurorinë, përveçse po të paraqitet ndonjë  
14 arsye e fortë për të mos e bërë këtë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Fillimisht  
16 dua që të them se keni shumë dokumente për të nxjerrë. E  
17 kuptoj plotësisht se duhet kohë që të përpunohet një nxjerrje,  
18 sepse doni që të siguroheni që të bëhet siç duhet mbrojtja e  
19 një dëshmitari, apo e një viktime dhe ju duhet kohë t'i  
20 shikoni këto dokumente. Këtë e kuptoj plotësisht.

21 Por, nga ana tjetër objektin e çështjes nuk është  
22 përgjegjësi e Mbrojtjes, është përgjegjësi e ZPS-së. Ju vetë  
23 ju është dashur që të përfshini shumë materiale në listën  
24 përkatëse, por nuk është Mbrojtja përgjegjëse për këtë.

25 E dyta. Siç e thashë në fjalën hyrëse për këtë kategori

1 materialesh, unë kam ndërmend që dosjen gjyqësore t'ia  
2 transferoj Trupi Gjykses të pastër. Nuk dua t'i çoj Trupit  
3 Gjykses një dosje e cila në vazhdimësi do ta detyrojë Trupin  
4 Gjykses që ta pezullojë procesin, sepse Mbrojtja mund të  
5 kërkojë informacione konkrete të cilat mund të çojnë në hetime  
6 të reja. Nuk do të ishte praktikë e mirë një gjë e tillë. Do  
7 ta ngadalësonte procesin në faza të mëpasshme.

8 Unë kam ndërmend që të transferoj, të kaloj një dosje  
9 gjyqësore ku Mbrojtja t'i ketë në dispozicion të gjitha provat  
10 që ka të drejtë t'i ketë, përfshirë dhe provat e rregullës  
11 102(3), të paktën pjesën më të madhe të kërkesave të  
12 përgjithshme që Mbrojtja ka bërë deri tani. Siç e tha edhe z.  
13 Ellis, gjithmonë mund të ketë kërkesa të veçanta të synuara në  
14 bazë të ecurisë së çështjes, por të paktën pjesa më e madhe e  
15 materialit 102(3) duhet që të jetë nxjerrë.

16 Edhe njëherë po e shpreh pyetjen që kisha: Kur vlerësoni  
17 se mund ta përbyllni nxjerrjen sipas rregullës 102(3) lidhur  
18 me kërkesat që janë bërë tashmë nga ekipet e Mbrojtjes? Nëse  
19 do të jetë më mbrapa se 22 korriku, mund të më jepni një datë  
20 orientuese. Mund të jetë në fakt një datë orientuese e cila  
21 sërish mund të ndryshohet nëse ju kuptoni se ju duhen një, dy,  
22 tre, katër apo më shumë javë. Këtë e kuptoj plotësisht. E  
23 kuptoj se është shumë punë dhe kërkon shumë kohë, por ajo që  
24 duhet të marrë parasysh ZPS-ja është se, nga nxjerrja e  
25 materialit varet edhe pjesa tjetër e fazës paraprake. Ju

1 pëlqen apo jo, kjo ka lidhje edhe me dosjen paraprake të  
2 ekipeve të Mbrojtjes dhe pastaj dhe me momentin kur unë mund  
3 t'ia kaloj çështjen Trupit Gjykues dhe kur Trupi Gjykues mund  
4 ta nisë procesin gjyqësor.

5 Më qartë apo më troç do të thuhej që afatet e kësaj  
6 çështje gjyqësore i keni ju në dorë dhe varet nga nxjerrja e  
7 materialeve të kategorive të tjera.

8 Nëse doni që të më përgjigjeni pas pushimit se dëshironi  
9 që të konsultoheni në përgjithësi, edhe këtë e kuptoj. Por, e  
10 thashë se dua që të caktoj një datë të synuar për këtë piketë  
11 procedurale dhe unë i qëndroj këtij synimi.

12 Keni fjalën.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
14 Dëshirojmë që të konsultohemi, pas pushimit ju japim një  
15 mendim më të qartë lidhur me atë që kërkuat. Ajo që sapo thatë  
16 është shumë e rëndësishme, se nëse flasim për nxjerrjen e  
17 pjesës më të madhe të materialit, kjo është më e realizueshme  
18 se sa për të gjitha materialet përpara se t'i kalohet dosja  
19 Trupi Gjykues.

20 Prandaj kërkoj që të konsultohemi që të propozojmë një  
21 afat duke mbajtur këtë parasysh.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Që të jem i  
23 qartë, kur thashë "pjesa më e madhe", e kam fjalën lidhur me  
24 atë çka është kërkuar nga Mbrojtja, jo se çfarë do të kërkojë  
25 në të ardhmen. Unë nuk desha që të caktoj, ta kufizoj se çfarë

1 propozon Mbrojtja. Edhe njëherë pyetja ime është kjo: Kur do  
2 të jeni në gjendje që të nxirrni dhe/ose të dorëzoni kërkesa  
3 të tjera për masa mbajtëse për materialin që ju mendoni se  
4 janë të nevojshme?

5 Dhe për këtë dua një datë për materialin që është kërkuar  
6 tashmë, deri tani, nga Mbrojtja. Kjo është pyetja ime. Sepse  
7 kjo është shumë e rëndësishme për mua që edhe unë të caktoj  
8 një afat për këtë. Dhe kjo pastaj do të ketë ndikim edhe tek  
9 afati për dosjen paraprake të Mbrojtjes. Pastaj një afat për  
10 kalimin e dosjes gjyqësore Trupit Gjykues.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Ju kuptuam, z. Gjykatës. Do t'ju  
12 japim përgjigje pas pushimit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Është ora  
14 5.07. Nëse përkthyesit më lejojnë, e di që duhet të jenë shumë  
15 të lodhur, kemi një pjesë shumë të shkurtër për materialin e  
16 rregullës 107 që nuk do e zgjas më shumë se 2 minuta.

17 Nëse preferoni që të bëni pushim tani. Nëse jo, mund të  
18 vazhdojmë me këtë.

19 PËRKTHYESI: Përkthyesit thonë po, që mund të vazhdojmë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Ju dëgjova  
21 dhe ju faleminderit shumë. E kuptoj që mund të jeni të lodhur,  
22 por ju falënderoj shumë sepse në këtë mënyrë, përveç kësaj  
23 pjesës së fundit, mund të vijojmë me nxjerrjen.

24 Kalojmë tani tek materiali i rregullës 107.

25 Vë re parashtrimet e ZPS-së që po vazhdon që të punojë në

1 mënyrë aktive për të kryer diskutimet me dhënësit e  
2 materialeve të rregullës 107. ZPS-ja tregon se po përgatit dy  
3 kërkesa të tjera sipas rregullës 107(2), përfshirë këtu dhe  
4 kryerjen e diskutimeve balancuese. I kërkoj ZPS-së që të bëjë  
5 parashtrimin për këtë temë, përfshirë këtu edhe afatin për dy  
6 kërkesat sipas Rregullës 107(2).

7 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi  
8 ndonjë datë konkrete për dorëzimin e këtyre kërkesave. Siç e  
9 kuptoni edhe ju, sa më të qarta të jenë ato që kuptojmë ne me  
10 kalimin e kohës, aq më të qartë do të jemi dhe. Kështu që, do  
11 të vijë një moment kur do të ketë një objekt më të vogël mbi  
12 të cilin mund vendosni të nderuar Gjykatës.

13 Përtej kësaj, do të vazhdojmë që të bëjmë punë aktive  
14 lidhur me këtë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim]

16 Faleminderit, z. Prokuror.

17 Ndonjë prej ekipeve të Mbrojtjes? Z. Kehoe?

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam për të thënë shumë për  
19 çështjet e rregullës 107, se nuk e kuptoj se për çfarë po  
20 flasim vërtetë. Por edhe njëherë duket si zgjatje afatesh, ku  
21 Prokurori ju jep disa parametra se kur do t'i marrë dhënien e  
22 pëlqimit. Ky është parametri kryesor, sepse është filli i kuq  
23 që lidh gjithë diskutimin këtu sot.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Po, kjo  
25 qëndron. Por qëndron edhe ajo që thotë Prokurori që, sa më

1 shumë pëlqime të marrin, aq më pak materiale do të përfshijnë  
2 në kërkesat e tyre dhe aq më shumë i nxirren Mbrojtjes.

3 Znj. O'Reilly apo z. Emmerson? Znj. O'Reilly.

4 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Kam  
5 nevojë për një sqarim.

6 Po flasim për dy kërkesa të rregullës 107(2), por ka edhe  
7 një listë edhe më të gjatë të kërkesave të rregullës 107, që e  
8 kishin përfshirë në parashtrimet e protokolluara. Unë nuk e  
9 kam të qartë se për çfarë vëllimi materiali po flasim, pa  
10 folur pastaj për kohën e nxjerrjes.

11 Nuk e di nëse mund të marrim një vlerësim qoftë edhe të  
12 për afërt nëse janë qindra apo mijëra faqe? Nëse ZPS-ja mund të  
13 na e thotë këtë. Kjo mund të jetë në mënyrë që ta mbyllim  
14 nxjerrjen në këtë kuadër, për të kaluar pastaj me Trupin  
15 Gjykues.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim]  
17 Faleminderit.

18 Z. Young.

19 Z. YOUNG: [Përkthim] S'kam asgjë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis?

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kam asgjë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Z.  
23 Prokuror, doni t'ju përgjigjeni dy Avokatëve?

24 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Çështja nuk ka të bëjë tek  
25 faqet, por tek dokumentet. Një miratim i marrë, mund të



1 mbulojë edhe një dokument që mund të jetë edhe me dhjetëra apo  
2 me mijëra faqe.

3 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Shumë shkurt.

4 Volumi i faqeve për ne është problem, sepse do të duhet  
5 t'i lexojmë. Kështu që unë e kuptoj këtë që thoni ju, por  
6 prapë e kemi të nevojshme që ta dimë që të përgatitemi për  
7 gjykim. Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Unë u  
9 kërkoj palëve që t'i vazhdojnë këto diskutime *inter parte*,  
10 sepse vërtetë ka ndikim tek organizimi i Mbrojtjes, sidomos sa  
11 i takon kohës që duhet t'i kushtojë analizës së këtij  
12 materiali.

13 Falënderoj edhe njëherë përkthyesit që më dhanë këto pesë  
14 minuta. Do ta ndërpresim seancën këtu për 20 minuta dhe pastaj  
15 do të rifillojmë. Z. Prokuror, keni nevojë për më shumë kohë  
16 apo 20 minuta është në rregull?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Duhet të mjaftojë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES GUILLOU: [Përkthim] Pas 20  
19 minutash do të rifillojmë për të kaluar me temën e hetimeve të  
20 Mbrojtjes.

21 Duke pasur parasysh që na ka mbetur edhe një sesion prej  
22 një ore e gjysmë, i ftoj palët që të jenë konciz në  
23 prezantimet e tyre. Përndryshe nuk do të jemi në gjendje që të  
24 trajtojmë edhe aspektet që kanë të bëjnë me racionalizimin e  
25 çështjes sot. Kështu që pastaj i ftoj palët të jenë konciz për

1 mbyllur këtu rendin e ditës.

2 Këtu ndërpritet seanca.

3 --- Pauza fillon në orën 17.12

4 --- Seanca rifillon në orën 17.34

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prokuror përpara se sa  
6 të fillojmë me hetimet e Mbrojtjes e keni fjalën ju për t'ju  
7 përgjigjur pyetjeve që kishin të bënin me materialin sipas  
8 rregullës 102(3).

9 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
10 Unë e parashikova që do të ishte e vështirë që të jepnim një  
11 vlerësim të besueshëm, por kjo në fakt rezultoi që të ishte e  
12 vërtetë.

13 Sa i takon njoftimit sipas rregullës 102(3) një prej  
14 çështjeve ka të bëjë me madhësinë e çështjes gjyqësore dhe jo  
15 domosdoshmërisht, domethënë madhësia e çështjes në vetvete  
16 lidhet me njoftimet për 102(3), por në rastin në fjalë  
17 madhësia e çështjes gjyqësore ka një ndikim të jashtëzakonshëm  
18 të njoftimeve, të cilat bien nën rregullën 102(3).

19 Është e qartë që disa prej ekipeve të Mbrojtjes janë më  
20 përzgjedhëse sesa të tjerë megjithatë, njoftimet të cilat bien  
21 nën rregullën 102(3) janë të shumta.

22 Megjithatë, duke pasur parasysh këtë dhe duke parë  
23 kërkesat të cilat kanë ardhur deri në këtë moment nga ekipet e  
24 Mbrojtjes dhe duke mos marrë parasysh kërkesat që mund të  
25 merren në të ardhmen, ne parashikojmë që kërkesat të cilat

1 kanë ardhur mbi bazën e dispozitave të rregullit 102(3) deri  
2 në shtator të këtij viti.

3 Pika e fundit që dëshirojmë të ngremë lidhur me këtë  
4 është që, së pari e vlerësojmë atë që thatë juve që doni që  
5 kjo çështje të zgjidhet përpara sesa çështja të dërgohet në  
6 Trupin Gjyqësor, por ne mbajmë të njëjtin pozicion që  
7 domosdoshmërisht është e nevojshëm që njoftimet sipas rregullit  
8 102(3) të përfundohen dhe që janë të nevojshme përpara se sa  
9 të dorëzohen dosjet paraprake. Zakonisht, gjykatat  
10 ndërkombëtare penale duke e krahasuar me këtë Gjykatë kanë  
11 dhënë njoftime të tilla 6 muaj përpara. Domethënë, kemi të  
12 bëjmë me një sistem statutor të ndryshëm dhe me një skemë  
13 statutore të ndryshme, por thjesht dëshirojmë të vëmë në  
14 dijeninë tuaj që koha për dorëzimin e dosjes gjyqësore  
15 paraprake jo domosdoshmërinë duhet të lidhet me njoftimet  
16 sipas detyrimit të rregullës 12(3). Ky është vlerësimi ynë.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

18 Tani le të kalojmë tek pika e hetimeve të Mbrojtjes dhe  
19 hapat pasardhës.

20 Tani do t'ja jap fjalën palës veçmas që të flasim me sa i  
21 takon vetë hetimeve të Mbrojtjes.

22 Së pari, dua që të më thonë palët se cila është ecuria e  
23 hetimeve të Mbrojtjes.

24 Së dyti, dëshiroj që të më thonë se cilat janë kërkesat e  
25 mundshme për mundësi unike hetimore.

1 Së treti, për njoftime për alibi ose shkaqe për  
2 përjashtim të përgjegjësisë.

3 Së katërti, për pikat juridike dhe/ose faktike.

4 Së pesti, për kundërshtimet lidhur me pranueshmërinë e  
5 materialit provues të nxjerrë dhe së fundi lidhur me dosjet  
6 paraprake të Mbrojtjes.

7 I ftoj palët që të jenë sa më konciz që të jetë e mundur  
8 për secilën prej pikave. Sepse në të kundërtën nuk do të kemi  
9 shumë kohë.

10 Atëherë, le të kalojmë me ecurinë e hetimeve të  
11 Mbrojtjes.

12 Në parashtrimet me shkrim Mbrojtja thotë që i vazhdon  
13 hetimet e saj, duke përfshirë këtu identifikimin e  
14 dëshmitarëve të mundur, realizimin e misionëve hetimore dhe  
15 rishikimin e materialeve provuese të nxjerra nga ZPS-ja.  
16 Megjithatë, Mbrojtja e Thaçit kujton se këto hetime mbeten të  
17 penguar, nga disa faktorë të ndryshëm që janë përtej  
18 kontrollit të Mbrojtja, përkatësisht, redaktimet e shumta të  
19 bëra nga ZPS-ja dhe nxjerrja e vonuar dhe e pjesshme e ZPS-së.

20 Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu mendojnë se hetime të  
21 caktuara nuk mund të përfundohen derisa ZPS-ja të ketë  
22 përfunduar detyrimet e saj për nxjerrjen e materialeve.

23 Dua t'u kërkoj ekipeve të Mbrojtjes të japin një  
24 përshkrim të shkurtër të gjendjes së hetimeve të tyre.

25 Fjala për ju z. Kehoe.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

2 Dëshiron që t'i marr njëra pas tjetrës, të gjitha së bashku  
3 apo njëra pas tjetrës këto çështje?

4 Së pari, ne vazhdojmë me hetimet tona, por do të doja të  
5 sillja në mendjen tuaj që ka redaktime të jashtëzakonshme, jo  
6 vetëm të deklaratave të dëshmitarëve por edhe të dokumenteve  
7 të tjera. Dhe nuk do të thoja që janë shumë të mëdhaja po janë  
8 edhe shumë volumizone. Kështu që është shumë e vështirë kur  
9 edhe në një rast për shembull, kur ne lexojmë transkriptet jo  
10 domosdoshmërisht intervistat, një prej elementeve shënohet me  
11 referencë, ndërkohë që kur shkojmë te dokumenti tjetër që ka  
12 shënime me ERN i gjithë dokumenti është i nxirë, domethënë ne  
13 nuk e dimë se çfarë thotë fare dëshmitari.

14 Kështu që e bën pthuaajse të pamundur për neve për të  
15 ditur se për çfarë flitet, në qoftë se nuk i kemi dokumentet,  
16 në qoftë se kemi kaq shumë redaktime në këto dokumente.

17 Atëherë nuk do i kthehem edhe një herë masave mbrojtëse,  
18 megjithatë, ne dimë që kemi 100 dëshmitarë me masa mbrojtëse,  
19 ndërkohë që 65 do të vazhdojnë të jenë anonimë përpara  
20 procesit gjyqësor. Dhe kjo i takon që është punë e  
21 jashtëzakonshme për Mbrojtjen, për ekipet e Mbrojtjeve që të  
22 ketë informacione për këta dëshmitarë për 65 dëshmitarë, vetëm  
23 30 ditë përpara procesit gjyqësor. Ndërkohë që kam  
24 përshtypjen që kemi 24 dëshmitarë të cilët do të na bëjnë me  
25 dije vetëm 30 ditë përpara dëshmisë së atyre, çfarë do ta

1 bëjmë edhe më të vështirë për ne. Ndërkohë që kemi edhe dy  
2 dëshmitarë të tjerë, identiteti i të cilëve nuk do të na  
3 zbulohet asnjëherë. Dhe më duhet të them që asnjëherë  
4 personalisht nuk kam marrë pjesë në procese gjyqësore kur ka  
5 qenë rasti apo kemi pasur këto lloj kompleksiteti.

6 Nuk po them që nuk po hetojmë në lidhje me çështje. Po  
7 hetojmë po thjesht po mundohem të them që jemi të penguar  
8 jashtëzakonisht nga redaktimet e mëdha, të gjera të cilat janë  
9 vendosur për dëshmitarët dhe deklaratat e tyre.

10 Megjithatë, klienti im dhe Mbrojtjet e tjera, klientët e  
11 tjerë dëshirojnë që kjo çështje të përfundojë përpara Trupit  
12 Gjykses sa më shpejt të jetë e mundur.

13 Lidhur me një çështje tjetër për të cilën ne morën disa  
14 sqarime dje, në fakt i kisha dërguar një letër ca kohë më  
15 përpara OSBE-së, sa i takon informacionit, ca informacione të  
16 caktuara. Kohët e fundit kam marrë letrën mbrapsht ku më  
17 thuhet që Zyra e Administrimit po bën ca protokolle lidhur me  
18 këto dokumente. Nuk mendoj që ZPS-ja është mundur që t'i  
19 shikojë këto dokumente.

20 Dhe vetëm dje kam marrë një njoftim përmes znj. Menegon  
21 që e dhënë vënë Zyra Administrative, që kërkesa duhet që të  
22 shkonte përmes Gjykatës në mënyrë që të mund të shikoheshin  
23 dokumentet e OSBE-së. Me të thënë të drejtën jam pak i humbur  
24 me të gjithë procedurën. Pra, unë sapo i kam dërguar në fakt  
25 OSBE-së dhe Kombeve të Bashkuara që kanë kërkuar për këto

1 dokument por nuk e di nëse mund të na jepni ndonjë udhëzim të  
2 mëtejshme në mënyrë që ta përshpejtojmë procesin. Ne duhet që  
3 këto dokumente të OSBE-së t'i kemi në dispozicion sa më shpejt  
4 të jetë e mundur. Ne duhet të bëjmë çfarë është e nevojshme në  
5 mënyrë të tillë që të sigurojmë përputhshmërinë dhe këtë  
6 çështje, këtë aspekt mund ta çojmë përpara sa më shpejt të  
7 jetë e mundur.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.

9 Z. Emerson.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Hetimet për  
11 çështjen kundër z. Veseli po vijoje mirë. Do t@i vazhdojmë  
12 hetimet edhe gjatë verës. Dhe jemi gati që të fillojmë  
13 procesin gjyqësor këtë vit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. Young.

16 Z. YOUNG: [Përkthim] Ne po vazhdojmë hetimet, ne po  
17 takohemi me persona të cilët janë me interes për ne. Siç u tha  
18 edhe nga z. Kehoe ne jemi penguar në mënyrë të jashtëzakonshme  
19 lidhur me redaktimet e shumta dhe urdhrat e anonimitetit, si  
20 dhe redaktimet e shumta të cilat janë të pranishme në aktakuzë  
21 dhe gjithashtu dhe dokumente të tjera të cilat na kanë penguar  
22 shumë në punën tonë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 Znj. Alangendra.

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] ne po vazhdojmë me hetimet dhe

1 jemi në një situatë të ngjashme siç u përmendën dhe nga ekipet  
2 e tjera të Mbrojtjes.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.  
4 Alagenda.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Shkurtimisht. Për të katër ekipet  
6 e Mbrojtjes më duhet të them që vetëm njëri prej ekipeve na  
7 dha një informacion pak më të shumë, lidhur me procesin e  
8 hetimit në këtë çështje

9 Dhe në fakt është turp që ne të flasim në gjerësi dhe të  
10 flasim për më tepër se gjysmë ore për raportin e Dick Marty  
11 dhe ndërkohë që të mos jepet një përditësim më i mirë i  
12 ecurisë së hetimeve në çështjet e tyre. Dhe mendoj që në  
13 konferencat e tjera për ecurinë e çështjes Mbrojtja duhet të  
14 japi më shumë informacion.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Komentet e Prokurorisë lidhur me  
16 gjërat që bëjmë apo nuk bëjmë neve nuk kanë lidhje fare me  
17 dështimet e ZPS-së për të plotësuar detyrimet e tyre.

18 Hetimet tona po vazhdojnë sa më shpejt që mundemi. Ne po  
19 punojmë shumë me të gjithë informacionin që ZPS-ja ka vendosur  
20 ta redaktojë dhe ta përjashtojë. Dhe ne nuk mund t'i çojmë  
21 hetimet më përpara, të ecim me ritëm më të shpejtë për faj të  
22 ZPS-së.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. z. Kehoe.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të flas edhe unë  
25 shkurtimisht, ju lutem, lidhur me këtë çështje?



1 Do të flas shumë shkurt.

2 Në qoftë se Prokuroria na kërkon që të bëjmë një analizë  
3 të detajuar lidhur me hetimet e Mbrojtjes, kam përshtypjen që  
4 zotëria në krahun tjetër do të zhgënjehet.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

6 Tani le të kalojmë tek pika që ka të bëjë me mundësitë  
7 unike hetimore.

8 Atëherë, lidhur me këtë pikë ne kemi dy ekipe të cilat  
9 kanë bërë një kërkesë për mundësi unike në pajtim me rregullën  
10 99(1) të Rregullores. Mbrojtja e Thaçit thotë që do t'i bëjë  
11 kërkesa të tilla për disa dëshmitarë të mundshëm. Mbrojtja e  
12 Thaçit parashikon se kërkesa të tilla do të parashtrohen  
13 brenda muajve të ardhshëm dhe pozicioni është që ky proces do  
14 të përfundojë deri në fund të viti.

15 Mbrojtja e Veselit ka identifikuar individë nga listat e  
16 ZPS-së për të cilat kërkon mundësi unike hetimore. Kështu që  
17 dua që t'ju kërkoj ekipeve të Mbrojtjes që të japim një afat  
18 kohor lidhur me këto kërkesa.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Gjykatës, ne kemi 9 persona të cilët  
20 duam që t'i deponojmë përpara procesit gjyqësor. Këto janë  
21 procese të cilat kanë ndodhur në periudhën 1998, 1999 disa  
22 prej tyre edhe më përpara kësaj kohe. Dhe ka pasur individë të  
23 cilët kanë qenë në terren në atë kohë dhe ndërkohë kanë një  
24 moshë të caktuar. Megjithëse ju urojmë më të mirën, mendoj që  
25 është mirë që të vijojmë me deponimin e tyre. Sepse ne po

1 merrmi këtu me 1500 orë të çështjes së Prokurorisë vetëm në  
2 provat e tyre, ndërkohë që po flasim për një çështje  
3 Mbrojtjeje dhe për thërritjen e dëshmitarëve të tillë për  
4 arsye të cilat unë sapo i thashë. Dhe siç thashë domethënë  
5 disa prej tyre janë më shumë dhe më të vjetër sesa 80 vjeç.  
6 Pra, të paktën kërkojmë që të kemi kërkesa për 9 persona. Mund  
7 të jetë edhe më shumë sa kaq në fakt dhe duam që këtë çështje  
8 ta sjellim përpara Gjykatës përpara fillimit të procesit  
9 gjyqësor. Dhe një pjesë e mirë e informacion ka të bëjë me  
10 dokumentet e Kombeve të Bashkuara, OSBE-së dhe dokumente të  
11 tjera, të cilat kemi kërkuar që t'i marrim nga ZPS-ja dhe nuk  
12 kemi pasur mundësi t'i marrim.

13 Pra, unë synoj që këto t'i trajtoj sa më shpejt të jetë e  
14 mundur. Megjithatë këta dëshmitarë kanë kërkuar dokumentet  
15 bazë dhe për këtë arsye kam shkuar te Kombet e Bashkuara dhe  
16 te OSBE-ja për të kërkuar këtë informacion.

17 Domethënë, kjo është ajo lloj procedure që ne po e  
18 kalojmë herë pas here tani.

19 Ju premtoj, i nderuar Gjykatës, që ne do të trajtojmë  
20 këtë proces sa më shpejt të jetë e mundur. Dhe arsyeja se pse  
21 me këto deponime duhet të vijojmë sa më shpejt të jetë e  
22 mundur, janë këto që unë thashë më përpara. Në qoftë se keni  
23 sugjerime se si të vijojmë me këtë aspekt, do t'i pranoni  
24 sugjerimet tuaja, sepse duam që këto çështje t'i trajtojmë sa  
25 më shpejt që të jetë e mundur sepse duam që çështja gjyqësore

1 t'i dërgohet Trupit Gjykses.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kjo do të realizohet përmes  
3 komunikimeve me Zyrën Administrative, jo në konferencën për  
4 ecurinë e çështjes.

5 Z. Emerson.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] S'kam gjë  
7 për të shtuar.

8 Z. Young.

9 Z. YOUNG: [Përkthim] Nuk kam gjë për të shtuar.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

11 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ne jemi duke u harmonizuar,  
12 duke u sinkronizuar me ekipet e tjera të Mbrojtjes dhe në  
13 qoftë se kemi kërkesa të tjera shtesë do t'jua bëjmë me dije.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Le të kalojmë te njoftimi  
15 për alibi ose shkaqe për përjashtimin e përgjegjësisë. Në  
16 parashtrimet e tyre me shkrim Mbrojtja rezervon të drejtën që  
17 të japë njoftim për alibi ose shkaqe për përjashtimin e  
18 përgjegjësisë.

19 Mbrojtja e Thaçit nuk është në gjendje që të japë  
20 informacion tani për shkak të gamës dhe shtrirjes së gjerë të  
21 redaktimeve në aktakuzë dhe në materialin provues. Mbrojtja e  
22 Veselit ka propozuar që ZPS-ja të lejojë Avokatin e Mbrojtjes  
23 në mënyrë konfidenciale që të shikojë materialin e redaktuar  
24 dhe që të drejtojë pretendimet kundër Mbrojtjes sa i takon  
25 ndihmimit të tyre në këtë çështje

1           Dua t'i kërkoj Mbrojtjes se kur kamë mundësi që t'i japin  
2 njoftim për alibi ose për përjashtim të përgjegjësisë.

3           Z. Kehoe.

4           Z. KEHOE: [Përkthim] Pozicioni im sa i takon çështjes së  
5 alibisë për të gjitha elementet që janë në aktakuzë, mbetet e  
6 njëjtë. Nuk mund t'ju japim një njoftim për një çështje të  
7 tillë për një pjesë të mirë të aspekteve që përfshihen këtu,  
8 për shkak të madhësisë së redaktimeve në dokumentet e ZPS-së.

9           Sinqerisht ju them z. Gjykatës, kur të kemi qartësi  
10 lidhur me datat dhe vendet, sepse klienti im në pjesën më të  
11 madhe të 1999-s ka qenë duke vizituar kryeqytete të vendeve të  
12 ndryshme në të gjithë botën dhe është përpjekur pra, që të  
13 sjellë paqen në Kosovë.

14          Pra, për këtë arsye në mënyrë të tillë që unë të kem një  
15 parashtrim më të qartë lidhur me alibinë duhet të kem datat  
16 dhe vendet dhe të them në këtë datë, për shembull, ka qenë në  
17 Bruksel apo në Zvicër apo ka qenë këtu apo ty.

18          Edhe një herë më lejoni të them z. Gjykatës, që kur të  
19 kemi qartësi lidhur me datat dhe vendet sigurisht që do t'i  
20 japim parashtrimet tona lidhur me alibinë.

21          GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22          Z. Emmerson.

23          Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Datat, kohët  
24 dhe personat. Këto janë çështje që duhet të sqarohen përpara  
25 sesa të bëjmë parashtrime që kanë të bëjnë me alibinë.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.  
2 Z. Young.

3 Z. YOUNG: [Përkthim] I nderuar Gjykatës nuk kemi mundësi  
4 që të japim informacion në këtë pikë të procesit gjyqësor dhe  
5 madhësisë së informacionit që akoma nuk na është nxjerrë.  
6 Kështu që nuk mund të bëj një parashtrim për momentin.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.  
8 Znj. Alagendra.

9 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk jam në gjendje që të jap  
10 një përgjigje për këtë pyetje tani.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani le të kalojmë në pikat  
12 e marrëveshjes, në pikat për fakte juridike dhe faktike. Në  
13 parashtrimet me shkrim Mbrojtja e Thaçit thotë që ka pranuar  
14 nga faktet e propozuara nga ZPS-ja. Në mënyrë që të  
15 përshpejtohet procesi për arritjen e marrëveshjes lidhur me  
16 faktet e propozuara nga ZPS-ja, Mbrojtja e Thaçit e fton ZPS-  
17 në të ofrojë një version më pak të redaktuar të aktakuzës dhe  
18 materialeve provuese me sa më pak redaktime.

19 Mbrojtja e Veselit ka marrë nën shqyrtim disa prej  
20 fakteve të propozuara për të cilat palët janë pajtuar dhe që  
21 nuk duket sikur që nuk varen nga nxjerrja sipas rregullit 103  
22 dhe ndërkohë Mbrojtja e Krasniqit po analizon faktet për të  
23 cilat palët pajtohen, por nuk mund të përgjigjet në më tepër  
24 hollësi derisa të përfundojë procesi i nxjerrjes.

25 I ftoj palët që të japin afate kohore sa i takon këtij

1 aspekti.

2 Z. Kehoe.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Për të theksuar edhe një herë atë  
4 çfarë thatë ju në seancën e fundit që derisa Mbrojtja të ketë  
5 marrë të gjitha materialet nga nxjerrja është e vështirë që  
6 Mbrojtja të bjerë dakord me faktet.

7 Mendoj se është shumë e rëndësishme për neve për të  
8 kontekstualizuar këto fakte.

9 Pra, në qoftë se nuk realizohet procesi i nxjerrjes së  
10 materialeve është e pamundur për neve për të bërë  
11 kontekstualizimi. Ne kemi materiale që bien nën rregullën  
12 102(3) që duhet të nxirren, materiale të rregullës 103 po  
13 ashtu, kështu që situata mbetet e njëjtë.

14 Pavarësisht kësaj ne do të angazhohemi që të shikojmë  
15 faktet e ekipeve të tjera të Mbrojtjes, si për shembull, siç u  
16 propozua nga kolegët më parë dhe do të shohim në qoftë se mund  
17 t'ju japim parashtrime në kohën e duhur.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Por juve thatë në  
19 parashtrimet tuaja që ju i pranoni nëntë faktet.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] I pranoj të nënta.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Por jo kjo nuk ju pengon që  
22 ta bëni këtë gjë edhe në qoftë se nuk merrni nxjerrjet për  
23 këto informacione.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] E bëra këtë gjë Gjykatës dhe duhet  
25 që të zgjidhim çështjen e salamandrës. Pra është në interesin

1 tonë që ta bëjmë këtë gjë, për aq sa mundemi, i nderuar  
2 Gjykatës dhe sigurisht që do të shohim edhe marrëveshje të  
3 tjera faktike që avokatët e tjerë do t'i identifikojnë dhe do  
4 të bëjmë një vlerësim në qoftë se do ta pranojmë apo jo atë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.

6 Z. Emerson.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ne do kemi  
8 një përgjigje për Prokurorinë lidhur me këtë aspekt deri në  
9 fund të këtij muaji. Çka do me thënë, që deri në fund të kësaj  
10 jave.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

12 Z. YOUNG: [Përkthim] Ne po rishikojmë aktivisht faktet  
13 për të përcaktuar në qoftë se pajtohem me to apo jo. Sa i  
14 takon pikave juridike mungesa e parashtimeve të pikave  
15 juridike në dosjen paraprake të Prokurorisë e bën thujtë të  
16 pamundur pasjen e një diskutimi të dobishëm lidhur me këtë  
17 pikë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

19 Znj. Alagendra.

20 Z. BAIESU: [Përkthim] Ne nuk mund të komentojmë më tej  
21 përveç asaj çfarë kemi thënë në parashtimet tona të  
22 protokolluara. Më lejoni të them që ne po vazhdojmë që të  
23 rishqyrtojmë dokumentet në mënyrë të tillë që të përfundojmë  
24 me nxjerrjen e informacionit.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. Prokuror, nuk e di në qoftë se keni ndonjë gjë për të  
2 shtuar dhe në qoftë se mund të bëni propozime me pikat  
3 juridike për t'i dhënë përgjigje pyetjes së ngritur nga z.  
4 Young.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Sa i takon këtij aspekti në fakt  
6 jemi në kontakt të vazhdueshëm me pikat juridike, përfshi këtu  
7 edhe gjërat apo pikat më të rëndësishme juridike, kështu që ne  
8 nuk e pranojmë parashtrimin që u bë nga Mbrojtja sepse ne  
9 duhet që të jemi në procesverbal lidhur me faktet, me ligjin,  
10 me provat në një nivel goxha më të lartë se sa Mbrojtja. Në  
11 këtë pikë shumë nga pikat e pajtuara ndërmjet palëve që prej  
12 vitit që shkoi -- pra nuk është bërë asnjë lloj progresi nga  
13 palët ndërkohë që kemi arritur në një pikë kur nuk duket sikur  
14 propozimi i mëtejshëm nga ana jonë nuk është se do të sjellë  
15 ndonjë produkt shumë të madh.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Arsyeja që pse diskutimi nuk është  
18 produktiv, është që ZPS-ja jep, pra fakte argumentuese. Pra  
19 jepen -- na është dhënë aktakuza ku ka redaktime të  
20 jashtëzakonshme ndërkohë që nuk kemi kontekstualizim të  
21 gjërave të cilat thotë ZPS-ja. Sepse në qoftë se nuk kemi  
22 kontekstin neve nuk mund të biem dakord me pikat faktike dhe  
23 juridike.

24 Dhe kur të nxirret informacioni besoj që, i nderuar  
25 Gjykatës, besoj se do ta kuptoni se për çfarë po flasim.



1 Pra çështja e detyrimeve është e qartë si dielli. Kështu  
2 që ne po bëjmë çdo gjë që është e mundur në mënyrë që të mund  
3 të vazhdojmë dhe të jemi sa më saktë që mundemi.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

5 Nuk shoh që ndonjë tjetër do të marrë fjalën.

6 Tani le të kalojmë te pjesa e dosjes paraprake të  
7 Mbrojtjes.

8 Në parashtrim me shkrim ekipet e Mbrojtjes thanë që  
9 synojnë që do të dorëzojnë dosjet e tyre paraprake. Mbrojtja e  
10 Thaçit thotë që do të jetë në pozicion, në pozitë për ta  
11 dorëzuar dosjen paraprake me 16 shtator 2022. Megjithatë,  
12 Mbrojtja e Thaçit thotë që kjo varet nga përmbushja e  
13 detyrimeve për nxjerrjet e informacioneve nga ZPS-ja deri në  
14 22 korrik 2022 dhe njoftimi i dëshmitarëve që ajo synon që të  
15 thërrasë gjatë gjashtë muajve të parë të gjykimit. Si dhe  
16 urdhrin apo rendin në të cilin ata, pra ZPS-ja kërkon që t'i  
17 thërrasë dëshmitarët me urdhrin me 22 korrik 2022.

18 Mbrojtja e Veselit mendon që nxjerrja duhet të  
19 përfundohet në një afat më të shkurtër dhe ZPS-ja duhet të  
20 përfundojë detyrimet sipas rregullës 103 deri më 20 maj si dhe  
21 të gjitha detyrimet e tjera për nxjerrjen e informacionit  
22 sipas rregullës 102(3) deri më 22 qershor 2022 dhe të japë  
23 informacionin për ekipet e Mbrojtjes në pajtim me rregullin  
24 102(3) deri me 22 korrik dhe më pas të përfundojë edhe  
25 detyrimet që ka të bëjë me rregullën 102(3) deri më 22 korrik

1 2022.

2 Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu mendon se data e dosjes  
3 paraprake lidhet me pjesën e mbetur të afatit procedural në  
4 veçanti me datën kur do të përfundojë nxjerrja e materialeve  
5 nga ZPS-ja.

6 I ftoj palët të japin qasjet e tyre lidhur me për këtë  
7 aspekt dhe dua t'ju them palëve që në fund të kësaj seance do  
8 të jap një datë tentative sa i takon dorëzimit të dosjes  
9 paraprake nga palët.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, jemi të  
11 angazhuar për ta dorëzuar dosjen paraprake me 16 shtator.  
12 Sigurisht duhet - kemi nevojë për nxjerrjen që duhet të na e  
13 bëjë ZPS-ja sipas angazhimit të saj. I nderuar Gjykatës i ka  
14 dhënë atyre urdhër që të përmbushin një urdhër për dorëzimin e  
15 dosjes së tyre paraprake.

16 Nëse ka këtu - pra të gjithë jemi të interesuar që ta  
17 çojmë sa më përpara këtë çështje -- sa më shpejt përpara këtë  
18 çështje - më falni. Prandaj s'duhet të ketë vonesa.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Pyetja është  
21 vendosur drejtpërdrejt në rendin e ditës nga ju nëse Mbrojtja  
22 mund ta përmbushë afatin e 16 shtatorit.

23 Ne këtë e kemi marrë si një lloj ftese për të parë edhe  
24 cilat janë pasojat procedurale për kalimin e çështjes Trupit  
25 Gjykues dhe caktimin e një date të gjykimit. Ne sigurisht që

1 mund ta përmbushin datën 16 shtator për dosjen paraprake  
2 sigurisht duke pasur parasysh kushtet përkatëse. Për shembull  
3 nëse nxirret material pas dorëzimit të dosjes paraprake,  
4 material i cili është me rëndësi, atëherë ne do të ishim në  
5 gjendje që ta ndryshonim ose të paktën nuk duhet të  
6 kritikohemi për mungesën e dosjes paraprake.

7 Por, qëllimi është që dosjen paraprake ta kemi më datë 16  
8 shtator për të dhënë mundësi që gjykimi të fillojë në dhjetor.  
9 Të gjitha përpjekjet për të vendosur një lloj disiplinimi mbi  
10 respektimin e afateve nga Prokuroria nuk kanë pasur rezultat  
11 deri tani. Atëherë, e vetmja mënyrë efektive për ta çuar  
12 përpara këtë është që të na nxisnin neve.

13 Me fjalë të tjera t'i kërkohet të nderuar Gjykatës që të  
14 vendosë një datë paraprake për fillimin e gjyqimit në dhjetor  
15 për hapjen e paraqitjes së provave nga ana e Prokurorisë,  
16 prandaj edhe nëse mund të mendojmë në bazë të kësaj, 16  
17 shtatori është një datë e logjikshme sepse është tre muaj  
18 përpara.

19 Por, pikësëpari për këtë duhet që të ketë përfunduar  
20 nxjerrjen në varësi të ndonjë aspekti të vogël. Kjo pastaj na  
21 jep ne mundësi për afërsisht gjashtë javë pas bërjes së  
22 nxjerrjeve për të finalizuar dosjen tonë paraprake.

23 Ne mund të punojmë me disa vështirësi aty-këtu,  
24 domethënë, me gjëra të cilat kanë nevojë për shtjellim të  
25 mëtejshëm por mendoj se ka ardhur koha që të ecim përpara dhe

1 të disiplinohet Prokuroria duke vendosur një afat kufi dhe  
2 afate dhe sanksione të tjera. Pra, 16 shtatori është në  
3 rregull për një dosje paraprake nga ana e ekipit të Mbrojtjes  
4 së z. Veseli, por ne gjithashtu ngulim këmbë që të fillojë dhe  
5 gjykimi sepse atëherë do të jetë një periudhë rreth afërsisht  
6 dy vjet pas arrestimit, pra mbajtjes në paraburgim të të  
7 akuzuarve.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. Young.

10 Z. YOUNG: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, Mbrojtja po  
11 mendon nëse do të dorëzojë apo jo një dosje paraprake. Siç e  
12 kupton, i nderuar Gjykatës, nga ana juaj është një ftesë por  
13 nuk është një kërkesë s detyrueshme.

14 Ne mendojmë se e gjithë kjo varet edhe nga kushtet që ka  
15 vendosur Mbrojtja e Veselit me parashtrimet e tyre me shkrim.  
16 Shumë do të varet edhe nga vendosja e afateve nga i nderuar  
17 Gjykatës për nxjerrjen e materialeve të rregullës 102(3) sepse  
18 Mbrojtja propozuar një numër, por tani Prokuroria ju ka thënë  
19 se ata angazhohen që ta dorëzojnë në fund të shtatorit.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Ellis.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, gjithmonë kemi  
23 mbajtur qëndrimin se dosja paraprake duhet që të lidhet me  
24 fundin e procesit të nxjerrjes. Sepse duhet të kalojë një  
25 periudhë dymujore nga fundi i kryerjes së nxjerrjeve deri në

1 dorëzimin e dosjes paraprake nga Mbrojtja.

2 Ky vazhdon të jetë qëndrimi ynë. Por, me shtyrjen në kohë  
3 të nxjerrjes nga ana e Prokurorisë atëherë i bie që të shtyhet  
4 edhe dorëzimi i dosje paraprake nga ana jonë. Ky është  
5 qëndrimi ynë, pra, sa i takon periudhës dymujore pas  
6 nxjerrjes.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. Prokuror, nëse mund t'u përgjigjeni disa prej  
9 propozimeve për afat apo propozimeve të tjera të ekipeve të  
10 Mbrojtjes për të pasur qasje në rendin e dëshmitarëve që  
11 synoni të paraqisni në gjykim.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Në fillim flasim për renditjen e  
13 dëshmitarëve.

14 E kemi në konferencat e tjera për ecurinë e çështjes.  
15 Renditja e dëshmitarëve ka të bëjë shumë me momentin kur  
16 fillon gjykimi me disponibilitetin e dëshmitarëve dhe me  
17 kalendarin e seancave që cakton Trupi Gjykses. Pra, çdo listë  
18 dëshmitarësh me renditje kohore që mund të japim tani, do të  
19 ndryshonte në shumë mënyra. Aq shumë sa që nuk mendojmë se do  
20 të ishte ndonjë - një renditje e kuptimtë, e logjikshme.

21 Ne mendojmë se kjo s'duhet të përbëjë kusht për dorëzimin  
22 e dosjes paraprake.

23 Tani të flas për dosjen paraprake. Do të ishte më mirë që  
24 të kishim pasur një diskutim më të gjatë për këtë sepse shumë  
25 prej parashtrimeve që dëgjuam sot janë të paqarta.

1 Mbrojtja e Krasniqit është i vetmi ekip i Mbrojtjes që në  
2 fakt e pranon se si afati 16 shtatorit lidhet me afatin --  
3 lidhet me fundin e shtatorit që unë e propozova si afat tani.  
4 Pra, nëse përmbushen kushtet mund të përmbushet 16 shtatori,  
5 thuhet nga ekipi i Mbrojtjes së z. Veseli. Nuk e di se çdo të  
6 thotë kjo se ne i kemi thënë tashmë se çfarë është e mundshme  
7 brenda këtyre kushteve. Pra ata nuk janë të angazhuar për  
8 asnjë afat të veçantë.

9 Si për shumë pikave të rendit të ditës, ekipet e  
10 Mbrojtjes kanë përmendur redaktimet që siç e di i nderuar  
11 Gjykatës kanë të bëjnë edhe me shtyrjen e nxjerrjes së të  
12 dhënave të dëshmitarëve. Këto redaktime nuk do të hiqen në atë  
13 shkallë sa të mund të dorëzohet një dosje paraprake sipas  
14 tyre. Dhe ne jemi të shqetësuar nga ekipet e Mbrojtja kur  
15 thonë që duan nxjerre të plotë sepse në këtë rast ata krijojnë  
16 një situatë që s'mund të ndodhë kurrë. Pra të presim që të  
17 hiqen redaktimet, në mënyrë që të dorëzojnë dosjet paraprake.  
18 Pra, që këtë fakt, që nuk mund të dorëzojnë, i nderuar  
19 Gjykatës.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nëse mundem.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

22 Në fillim z. Kehoe.

23 Por përpara se t'ju jap fjalën nuk e di nëse mund të na  
24 thoni çfarë do të ishte një datë e mundshme për dosjen  
25 paraprake nëse ZPS-ja do t'i përmbyllte detyrimet sipas

1 rregullës 102(3) pra detyrimet për nxjerrjen deri në fund të  
2 shtatorit.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Në përgjithësi në përputhje me atë  
4 që tha përfaqësuesi i Prokurorisë më përpara, zakonisht duhen  
5 dy muaj pas nxjerrjes. Por, në bazë të asaj të ecures që kemi  
6 parë deri tani, unë shpresoj që fundi i shtatorit të jetë data  
7 realiste jo thjesht një datë që Prokuroria thjesht e nxjerr  
8 këtu për t'u bërë qejfin ju z. Gjykatës.

9 Çfarë kërkojmë ne, pra duam nxjerrje të plotë. T'i heqim  
10 mënjane këto gjëra të pakuptimta që dëgjuam tani. Duam  
11 nxjerrje të plotë në mënyrë që ne të dorëzojmë dosja paraprake  
12 dhe ta çojmë përpara çështjen gjyqësore. Këtë duam të bëjmë.  
13 Nuk po luajmë shah apo po nxjerrim argumente të pavlefshme. Ne  
14 thjesht duam që i nderuari Gjykatës të nxjerrë pikërisht  
15 urdhrin që të bëjnë atë që duhet.

16 Sa i takon renditjes së dëshmitarëve kjo ka shumë  
17 rëndësi. Shumë i rëndësishëm, mund të ketë ndryshim në  
18 renditjen e dëshmitarëve, por për të ecur përpara me shpejtësi  
19 na duhet një skemë e caktuar që do të ndjekë Prokuroria. Nga e  
20 kuptojmë këtë? E di se nga puna ime para 25 vjetësh si  
21 Prokuror. Sepse një Prokuror e di se ç'drejtimit do t'i japë  
22 çështjes pavarësisht që mund të ketë ndryshime nëpër të.  
23 Prandaj nuk është e saktë ajo që tha Prokurori këtu.

24 Ndërkohë që Prokurori është këtu e di se çfarë drejtimit  
25 do t'i japë çështjes së vet dhe se cilët dëshmitarë do të

1 paraqesin këtu gjatë gjashtë muajve të parë. Këtë kërkojmë.  
2 Kërkojmë këtë në mënyrë që të na japë mundësi të ecim përpara.  
3 Për të ecur përpara me diçka me më pak, pra, se tre vjet sepse  
4 nuk e di sesa orë dëshmie kanë kërkuar 1500-1600.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit

6 Z. Emerson.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Dy pika të  
8 shkurtra.

9 E para, për parashtrimet e çuditshme që dëgjuam këtu, një  
10 datë të nxjerrë kështu në mënyrë të papritur pas konsultimeve  
11 gjatë pushimit të shkurtër. Këtë e bëjnë thjesht për t'a  
12 nxjerrë të pakuptimtë angazhimin tonë. Sepse vetë ZPS-ja nuk  
13 mund t'i përmbushë angazhimet e veta për nxjerrën brenda datës  
14 që ato kanë treguar.

15 Me fjalë të tjera, shkelja e vazhdueshme që u ka bërë  
16 urdhrave deri tani ZPS-ja mund të na bëjë që të hedhim hije  
17 dyshimi edhe mbi këtë datë të re që ata propozojnë. Ato e kanë  
18 shprehur edhe në mënyrë të përkohshme.

19 Qëndrimi është shumë i qartë. Ne do ta dorëzojmë dosjen  
20 tonë paraprake më datë 16 shtator edhe sikur Prokuroria ende  
21 në atë moment nuk i ka përmbushur të gjitha detyrimet lidhur  
22 me përmylljen e nxjerrjes së materialeve. Të gjitha këto kanë  
23 lidhje me kërkesat që janë bërë deri tani.

24 Se ata nuk mund të thonë që ne nuk i mbushim detyrimet,  
25 nuk mund t'i zihet besë Mbrojtjes. Jo. Ne do ta përmbushim



1 datën 16 shtator, do ta respektojmë. Por më bëhet qejfi që  
2 ZPS-ja mendon se kjo është e dobishme sepse arsyeja përse do  
3 ta bëjmë këtë dorëzim më 16 shtator se kemi nevojë që të  
4 caktojmë datën për fillimin e gjykimit, sepse në atë moment do  
5 të kemi dorëzuar dosjen paraprake dhe të paktën do të thotë që  
6 shumë shpejt do të fillojë edhe gjykimi.

7 Duke qenë që Prokuroria thotë që s'mund t'ju japim  
8 renditjen e dëshmitarëve derisa të kemi datën e fillimit të  
9 gjykimit atëherë ju kërkojmë që të vendosni 16 shtatorin si  
10 datë për fillimin e gjykimit. Kjo na jep neve kohë, mundësi që  
11 të përgatitemi edhe gjatë pushimeve. Dhe kjo na jep mundësi që  
12 të marrim nga ZPS-ja dhe renditjen e dëshmitarëve që  
13 dëshirojnë të thërrasin. Se po të mendojmë madhësinë e kësaj  
14 çështjeje gjyqësore, numrin shumë të madh të dëshmitarëve, të  
15 cilën unë do ta përmend pas pak, është si balena e cila tret,  
16 ha dhe tret ato organizmat e vogla të detit përmes një  
17 filtrimi. Vëllimi i materialit është shumë i madh. Materiale  
18 shumë të rëndësishme - më falni - dhe materiale jo dhe aq të  
19 drejtpërdrejta që Prokuroria kërkon t'i përfshijë e bëjnë  
20 shumë të vështirë parashikimin e punës që do të na duhet të  
21 bëjmë për të qenë të gatshëm për gjykimit.

22 Megjenëse kjo kërkohet nga ana jonë, atëherë dhe ne ju  
23 kërkojmë që po, 16 shtatori do të respektohet nga ne, por po  
24 kështu edhe gjykimi të fillojë më 16 dhjetor.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. Alagendra.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës nuk kam  
3 asgjë për të shtuar.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të lëshoj një urdhër  
5 gojarish në fund të punimeve sot.

6 Do të flas tani për efikasitetin e procedurave.

7 Në urdhrin për caktimin e datës, i kam pyetur palët nëse  
8 mund të japim një përditësim lidhur me diskutimet e tyre *inter*  
9 *parte* dhe të paraqesin propozime lidhur me racionalizimin e  
10 procesit gjyqësor.

11 Në parashtrimet e tyre me shkrim, palët duket se bien  
12 dakord se duhet të kenë të drejtë të paraqesin prova, siç e  
13 shikojnë të arsyeshme brenda një kufiri sa i takon numrit të  
14 orëve.

15 ZPS-ja bën të ditur se do ta pakësojë në mënyrë të  
16 konsiderueshme numrin e orëve që synon të përdorë për t'u bërë  
17 pyetje dëshmitarëve që do të thërrasë. I kërkoj ZPS-së të na  
18 japë shifra në lidhje me numrin orëve që parashikon.

19 Mbrojtja e Thaçit parashtron se pranimi i dëshmimeve me  
20 shkrim dhe jo me gojë do të ishte një mënyrë për të  
21 përshpejtuar procesin gjyqësor sidomos për dëshmitarët që kanë  
22 dëshmi që është e njëjtë me të tjerë dhe nuk i referohen të  
23 akuzuarve.

24 Megjithatë, Mbrojtja e Thaçit se objekti i kësaj duhet të  
25 jetë i kufizuar dhe se Mbrojtja do të kishte kundërshtim për

1 pranimin e dëshmimeve me shkrim nëse këto kanë lidhje me  
2 veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve.

3 U kërkoj palëve të thonë nëse janë dakord me këtë qasje.

4 Mbrojtja e Veselit që mbështetet edhe nga Mbrojtja e  
5 Krasniqit propozon që t'u caktohet një afat palëve për  
6 paraqitjen e provave të tyre përkatëse dhe propozon që ZPS-së  
7 t'i lihet në dispozicion një vit për të paraqitur provat e  
8 veta, me një zgjatje të mundshme tremujore për vonesa të  
9 paparashikuara. Sipas Mbrojtjes së Veselit kjo do të kishte  
10 për rezultat një gjykim dy deri në tre vjeçar.

11 I ftoj palët që të bëjnë të ditur nëse janë dakord me  
12 këtë afat të përgjithshëm të propozuar.

13 Sipas parashtrimeve me shkrim, diskutimet *inter partes*  
14 nuk kanë qenë të suksesshme për disa tema të tjera. Për  
15 shembull ZPS-ja bën të ditur se asnjë ekip i Mbrojtjes nuk ka  
16 bërë një propozim për të pranuar pranueshmërinë e ndonjë prove  
17 që është në listën e dëshmitarëve të ZPS-së. Po kështu ZPS-ja  
18 refuzon disa prej propozimeve të Mbrojtjes, të tilla si t'u  
19 jepet mundësia avokatëve të mbrojtjes që të shohin materialin  
20 e redaktuar që do të kërkonte një kërkesë për të rishikuar  
21 masat mbrojtëse të mëparshme; dhënia Mbrojtjes -- që t'i jepet  
22 Mbrojtjes një listë e dëshmitarëve që synon të thërrasë gjatë  
23 gjashtë muajve të parë të gjykimit, për këtë folëm; heqja e të  
24 gjitha pretendimeve që nuk kanë të bëjë me sjelljen personale  
25 të të akuzuarve apo me anëtarë të tjerë të përmendur me emër

1 të NPK-së dhe heqja e dëshmitarëve apo vendeve të krimeve në  
2 këtë moment, duke pasur parasysh që viktimat kanë 20 vjet që  
3 presin që të dëshmojnë dhe kanë nevojë që t'u jepet kjo  
4 mundësi.

5 Duke pasur parasysh që këtu nuk po flas vetëm për këto  
6 çështje, por edhe të tjera, dua t'ju kërkoj që të flasim në  
7 mënyrë precize për këtë temë, duke pasur parasysh që kjo do të  
8 diskutohet edhe në konferencën e ardhshme të ecurisë së  
9 çështjes. Prandaj ju kërkoj vetëm mendime paraprake dhe vetëm  
10 për këtë.

11 Z. Prokuror keni fjalën.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

13 Pra, fjala jonë do të jetë verbale sot, por do t'ju japim  
14 një përditësim më të plotë më pas për këtë temë.

15 Diskutimet *inter partes* kanë arritur në konsensusin që  
16 palët duhet të jenë të lira që të paraqesin provat e tyre në  
17 vartësi të një afati të caktuar. Tani kohëzgjatja e paraqitjes  
18 së provave, kohëzgjatja e përgjithshme e gjykimit varet nga  
19 kalendari i seancave dhe pushimet që janë midis tyre. Pra nuk  
20 do të ishte shumë efikase që ta bënit ju këtë gjë. Kjo duhet  
21 bërë nga Trupi Gjykues kur Trupi Gjykues ta ketë kalendarin e  
22 seancave.

23 ZPS-ja po e pakëson numrin e orëve që vlerëson, brenda  
24 për brenda e kemi bërë këtë diskutim dhe në përgjithësi kjo do  
25 ta zvogëlonte kufirin e orëve. Ky shqyrtim i brendshëm që

1 bëjmë ne merr parasysh shumë faktorë. I nderuari Gjykatës  
2 përmendi një që është shumë i rëndësishëm, siç janë viktimat  
3 që kanë 20 vjet që presim që të dëshmojnë dhe të tregojnë  
4 historinë e tyre, në këtë rast.

5 Ne mund t'i kërkonit të nderuar Gjykatës që të vendoste  
6 një afat pak kohë përpara se dosja gjyqësore t'i kalohet  
7 Trupit Gjykues në mënyrë që ne pastaj të kemi një numër të  
8 rishikuar. Sa i takon shifrave. Një përditësim i përkohshëm.  
9 S'ka përfunduar kjo. Pra ne e kemi bërë një pakësim 500 orë po  
10 do të vazhdojë që të bjerë. Pra do të vazhdojë që të  
11 zvogëlohet. Pra ne po vazhdojmë që të bëjmë shqyrtime të  
12 brendshme.

13 Siç e thamë dhe në parashtrimin tonë të protokolluar,  
14 pra, sa i takon heqjes së ndonjë dëshmitari apo pike, vendi,  
15 krimi për këtë ne nuk do të presim pra për afatin, por do t'ju  
16 informojmë menjëherë.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Ne e pranojmë këtë që zbret nga 1563  
19 orë në diku 1363 orë. Ne më përpara i kemi kërkuar ZPS-së që  
20 ta pakësojë edhe numrin e dëshmitarëve po ata nuk janë  
21 përgjigjur. Mendoj, pra, se mund ta caktojë Gjykata numrin e  
22 dëshmitarëve dhe numrin e orëve.

23 Ne i bashkohemi parashtrimin të Veselit. Sa i takon një  
24 afati, mendoj se një vit për të paraqitur provat e tyre është  
25 më se i mjaftueshëm në mënyrë që të mos vazhdojë në pafundësi

1 ky gjykim. Pra nëse caktohet ky afat një vjeçar mendojmë se  
2 është i përshtatshëm dhe ne pastaj si Mbrojtje, mund ta ndajmë  
3 kohën mes nesh në përputhje me këtë.

4 Unë nuk kam ndërmjet që t'i drejtohem Trupit Gjykses ende  
5 për t'i dhënë zgjidhje çështjes së masave mbrojtëse. E kuptoj  
6 që kjo është vendosur. Por, informacioni dhe nxjerrja e tij  
7 është i rëndësishëm se kur nuk na nxirret informacion atëherë  
8 e vështirëson edhe kohën. Sepse ne për shumë dëshmitarë ne do  
9 ta marrim informacion 30 ditë para gjykimit. Për 4 dëshmitarë  
10 të tjerë, do të zbulojë ky informacion në vartësi edhe të  
11 kushteve të tjera, e kështu me radhë.

12 Ecuria e kësaj çështje gjyqësore do të përshpejtohej do  
13 të përshpejtohej - më falni - nëse do të rimendoheshin këto  
14 afate nga i nderuar Gjykatës. Faleminderit.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.

16 z. Emerson.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Kam shumë  
18 pak për të shtuar për pjesën e parë të kësaj analize që është:  
19 Nëse a duhet të jetë një numër i përgjithshëm, numër total  
20 orësh apo një afat për paraqitjen e provave nga ZPS-ja.

21 I nderuar Gjykatës i ka kuptuar argumentet tona pra që  
22 nëse ZPS-ja do të përballlet me një afat, siç do të përballlet  
23 edhe Mbrojtja, do të jetë edhe Mbrojtja objekt i kësaj,  
24 atëherë kjo automatikisht do të kishte për pasojë që do të  
25 fokusoheshin të gjithë se çfarë është e nevojshme për gjykimin

1 e kësaj çështjeje.

2 Dhe unë e kuptoj shumë mirë që i nderuari koleg duhet që  
3 të vendosë në drejtpeshim të drejtat e viktimave për të pasur  
4 një mundësi që të kërkojnë drejtësi. Por nga ana tjetër nuk  
5 duhet harruar që të akuzuarit janë në burg. Edhe kjo duhet  
6 mbajtur parasysh. Sepse garancia e arsyeshme kohore e nenit 6  
7 të KEDNJ-së, është më e rëndësishme në këtë aspekt.

8 Ne ju kërkojmë që të mos harroni se nëse e pranoni  
9 parashtrimin tonë, ose në qoftë se Trupi Gjykses e mbështet  
10 parashtrimin tonë, duhet të ketë një numër kufi total muajsh  
11 që i jepet në dispozicion Prokurorisë për të paraqitur provat  
12 e veta.

13 Kjo do të ketë -- pra sepse nëse të akuzuarit do të  
14 shpallen të pafajshëm në fund të gjykimit atëherë do të kenë  
15 ndenjur deri atëherë pesë vjet në burg. Dhe kjo është shumë e  
16 pamendueshme.

17 Ne po përballemi me këtë situatë. Flasim për pesë vjet,  
18 pesë vjet derisa të ketë dalë një vendim nderuar Gjykatës  
19 Trupi Gjykses. Dhe çfarëdolloj gjëje tjetër -- nëse mendohet  
20 pra që të shkohet përtej pesë vjetëve për mendimin tonë është  
21 e pamendueshme dhe kjo i shkel edhe të gjitha parimet bazë për  
22 gjykimin e një çështje penale.

23 Nuk është faji ynë që Prokurorisë i janë dashur dy vjet,  
24 për të përmbushur detyrimet e veta ndërkohë që para dy vjetëve  
25 na ka thënë që ishte e gatshme për gjykimin.

1 Nuk është faji ynë që ata po përpiqen që të fusin lloj-  
2 lloj dëshmitarësh në listën e tyre. Ata sugjerojnë që thjesht  
3 të shkurtojnë kohën për secilin dëshmitar. Pra, propozojnë që  
4 të gjithë dëshmitarët t'i thërrasin dhe të dalin përpara  
5 Trupit Gjykues dhe t'i kalojnë me dyfishin e shpejtësisë. Jam  
6 i sigurt që përkthyesit dhe stenografët nuk do të ishin aspak  
7 të kënaqur me një gjë të tillë.

8 Po ata nuk e kanë për detyrë, pra Prokuroria nuk e ka për  
9 detyrë që të thërrasë përpara Trupit Gjykues të dalë çdo  
10 person që ka shprehur një pakënaqësi apo një ankesë. E vemja  
11 mënyrë që mund ta detyrojmë Prokurorinë që të kryejë detyrën  
12 është t'i caktohet afat për paraqitjen e provave të tyre.

13 Nuk mund të mendojmë që këta persona të kenë qëndruar në  
14 burg gjashtë apo shtatë vjet derisa të dalë një vendim lidhur  
15 me fajësinë apo pafajësinë e tyre.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] [Përmes videolidhjes]  
17 Faleminderit, z. Emmerson.

18 Z. Young.

19 Z. YOUNG: [Përkthim] Shumë shkurt. Ne me gjithë zemër e  
20 mbështesin qasjen e avokatit të Veselit që mendojmë se është e  
21 logjikshme që t'i vendoset një periudhë kohore, fikse, të  
22 themi një vit dhe Prokuroria ta zbatojë pastaj këtë afat.

23 Sa i takon uljes së, pra, pakësimit të kohës për këtë  
24 çështje gjyqësore barra i mbetet Prokurorisë, sigurisht. Pra,  
25 ne shpresojmë që i nderuar Gjykatës do të japë ato urdhra që



1 mund të japë në këtë moment.

2 Sa i takon pakësimit të numrit të orëve, kjo është e  
3 mirëpritur nga ana jonë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 z. Ellis.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Siç e kemi thënë edhe ne synojmë që  
7 të dorëzojmë parashtrimet tona me shkrim sonte, por ne  
8 mbështesim parashtrimet e bëra nga Mbrojtja e Veselit dhe z.  
9 Emmerson sot pasdreke.

10 Lloji i pakësimit të numrit të orëve prej 500 orësh që  
11 thotë Prokuroria është diçka. Megjithatë nuk është e  
12 mjaftueshme. Flasim për një çështje shumë të gjatë. Flasim për  
13 tre vjet nëse s'ka vonesa. Pra s'është aspak e mjaftueshme  
14 kjo, prandaj dhe ne mbështesim afatin njëvjeçar.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Do të doja edhe unë të  
16 përgjigjesha të jepja edhe unë parashtrimet e miya por mbase  
17 edhe z. Laws do të thotë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju mund ta merrni fjalën,  
19 por duhet t'jua jap unë fjalën. Dhe përpara se t'jua jap  
20 fjalën juve do t'ja jap fjalën z. Laws i cili përfaqëson  
21 viktimat.

22 Z. LAWS: [Përkthim] Dëshirojmë edhe ne të japim mendimet  
23 tona për çështjen e racionalizimit të procesit gjyqësor.

24 Ajo që duam të themi është kjo. Vendimi se kush duhet të  
25 dëshmojë në këtë çështje gjyqësore duhet që të mbështetet në

1 atë se cilat janë problemet kryesore në këtë.

2 Ne nuk mund të ndikojmë në kohëzgjatjen e kësaj çështje  
3 gjyqësore. Nuk mund të propozojmë mënyra se si të pakësohet  
4 objekti i provave. Kjo është në dorë të palëve. Prandaj dhe ne  
5 nuk kemi bërë parashtrim për këtë. Por viktimat preken  
6 drejtpërdrejtë nga kjo në dy mënyra.

7 Së pari, asnjë prej këtyre dëshmitarëve dëshiron që të  
8 konsiderohen si të panevojshëm. Dhe të gjitha viktimat  
9 pjesëmarrëse mezi presim që ky gjykim të përfundojë sa më  
10 shpejt.

11 Këta janë faktorët tek të cilët i mbështes parashtrimet e  
12 mia. Aty ku ka vend për të kursyer kohë është në lidhje me  
13 dëshmitarët që kanë të bëjnë me fjalën, frazën, baza e krimit.  
14 Por dua ta shpjegoj këtë për ata që s'e dinë. Është prova në  
15 lidhje me kryerjen e vetë krimit, pra rrëmbimet, ndalimet,  
16 keqtrajtmet dhe vrasjet.

17 Çfarëdolloj gjëje që mund të thuhet apo mund të mos  
18 thuhet sa i takon përfshirjes së shteteve të tjera apo  
19 besueshmërisë së provave në fund të këtij procesi gjyqësor do  
20 të jenë shqyrtuar shumë prova të cilat do të kenë -- do ta  
21 kenë kaluar këtë standard që dhe do kenë treguar që vërtetë ka  
22 pasur rrëmbime, ndalime, keqtrajtme dhe vrasje.

23 Çështja është pastaj këtu, a lidhen këto me të akuzuarit  
24 apo jo. Ky është tjetër aspekt. Prandaj, kundrejt këtij  
25 konteksti, ne e mirëpresim planin e ZPS-së që të përdorë më

1 shumë në paraqitjen e provave sipas rregullës 153 deri 155 dhe  
2 mirëpresim edhe gatishmërinë e Mbrojtjes së Thaçit për të  
3 menduar përdorimin e tyre.

4 Por mendojmë se ka një mbivendosje se ka një mbivendosje  
5 midis racionalizimit të çështjes gjyqësore dhe temës së fundit  
6 të rendit të ditës, që është dosja paraprake.

7 Nëse shohim rregullën 95(5) aty shohim se çfarë duhet të  
8 përmbajë dosja paraprake e Mbrojtjes.

9 Por për ta thënë ndryshe, dosja paraprake duhet që të  
10 identifikojë akuzat dhe çështjet për të cilat palët kanë  
11 kundërshtim dhe duhet që të ketë referenca në paragrafët e  
12 dosjes paraprake të Prokurorisë dhe duhet që të jepen arsytet  
13 përse kundërshtohen këto aspekte. Pra, është një kërkesë shumë  
14 konkrete. Pra, sigurisht Mbrojtja nuk e ka për detyrim që ta  
15 dorëzojë një dosje paraprake, por në momentin që e dorëzon  
16 dosjen paraprake duhet që të respektojë këto kritere.

17 Pra nëse dosjet paraprake ndjekin kërkesat e rregullës  
18 95(5) atëherë do ta dimë pasi të jenë dorëzuar këto dosje  
19 paraprake në mënyrë më precize lidhur me bazën penale, bazën e  
20 krimit se çfarë diskutohet dhe çfarë nuk diskutohet në këtë  
21 rast. Dhe kjo do ta bënte shumë më të lehtë edhe paraqitjen e  
22 provave sipas rregullës 153 deri 155 dhe kjo pastaj do të  
23 ndihmonte në racionalizimin e çështjes. Pra, pas momentit të  
24 dorëzimit të dosjeve paraprake.

25 Çfarë po themi këtu? Po themi se vendimi se cilët

1 dëshmitarë do të thirren nuk duhet që të cenojë -- pra nuk  
2 duhet të bëhet pa pasur parasysh këta faktorë të tjerë. Për  
3 shembull, në parashtrimin e protokolluar të Thaçit në  
4 paragrafin 18 thuhet se Mbrojtja thekson se i takon ZPS-së që  
5 ta racionalizojë paraqitjen e provave nga ana e vet.

6 Vendimi që duhet të marrë Prokuroria lidhur me këtë dhe  
7 vendimi që duhet të marrë Trupi Gjykses duhet të jetë një  
8 vendim i cili të merret duke pasur parasysh aspektet dhe  
9 problemet e vërteta të kësaj çështjeje gjyqësore.

10 Prandaj sugjerojmë kështu, që çfarëdolloj progresi që  
11 mund të bëhet tani për uljen e numrit të orëve të punës,  
12 atëherë kjo duhet që të bëhet -- dhe nëse ky vendim duhet të  
13 merret tani, duhet që të rishikohet edhe më mbrapa.

14 Ju falënderoj shumë që më dhatë mundësinë për këto  
15 parashtrime.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përpara se t'ua jap fjalën  
17 përsëri palëve dhe Prokurorisë, ju ftoj të mos fokusoheni  
18 shumë në llogaritë, përllogaritjen me orë apo vite sepse ka  
19 një variabël që nuk e di askush se sa orë dhe sa ditë mund të  
20 qëndrojë, mund të zhvillohet procesi. Kur ta kemi këtë  
21 variabël, numri i orëve dhe kohëzgjatja do të jetë relativisht  
22 e ngjashme, sepse nga ana matematikore na mungon në këtë  
23 ekuacion një variabël.

24 Z. Prokuror keni fjalën.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

1 Ka diçka që doli nga parashtrimet që ka rëndësi ta  
2 trajtojmë tani. Që të marr hua gjuhën e Emmersonit, ta kemi  
3 parasysh për të ardhmen në lidhje me atë që tha Mbrojtja e  
4 Thaçit për urdhrat e vonuara.

5 Vendimi për masa mbrojtëse që keni marrë ju, të gjithë  
6 kanë qenë në shtim e sipër sepse ju keni pasur parasysh  
7 drejtësinë e Gjykatës dhe kjo gjë është përsëritur gjithmonë.  
8 Mbrojtja e Thaçit duket sikur thotë që gjatë këtyre urdhrave  
9 në qoftë se këto urdhra nuk hiqen për masa mbrojtëse nuk mund  
10 të fillojë gjyqi për 30 ditë.

11 Duhet sikur në këtë mënyrë rezervohet një kërkesë për  
12 shtyrje përpara se të fillojë gjyqi dhe gjë që do t'i minonte  
13 të gjitha përpjekjet tona për ta bërë sa më efikas. Doja ta  
14 kishim për procesverbal.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Kur ju përcaktuat masat mbrojtëse  
16 për të gjithë këta dëshmitarë, ju them se ju nuk kishit ide se  
17 Prokuroria do të dilte me propozimin prej 1863 orëve për  
18 përgatitjen e çështjes së saj. Kjo ka ndodhur shumë kohë kur  
19 ju morët vendim në atë kohë të caktuar lidhur me këta  
20 dëshmitarë, duke mos - duke mos ju shkuar mendja aspak se  
21 miqtë e mi nga ana tjetër do të përdornin gjithë ato orë për  
22 të paraqitur çështje.

23 Sugjerimi im është në qoftë se duam të ecin përpara me  
24 shpejtësi jo vetëm para gjykimit por edhe në gjyq kërkojmë me  
25 respekt që ju ti mendoni, rimendoni disa nga këto afate për

1 nxjerrje. Sepse 98 dëshmitarë [sipas përkthimit] varet se  
2 çfarë do thoni. Unë kam marrë gjithë ato faqe bosh, bosh nga  
3 Prokuroria lidhur me. Është shumë vështirë ta marrësh me mend  
4 se çfarë do të paraqesin ata.

5 Por të punosh në abstrakt, në erë, unë ju them se nëse  
6 duam ta përshpejtojmë apo një mënyrë për ta thjeshtuar  
7 çështjen është të heqim kuadrin 30 ditë që kur të vijmë në  
8 gjyq gjërat të ecin më shpejt. Nuk po rezervoj asgjë, thjesht  
9 po ju jap një pikë reference. Juve dhe Trupit Gjykoes si një  
10 mënyrë për të ecur përpara, më përpara.

11 Gjatë gjyqit 30 ditë përpara se të dëshmojë një dëshmitar  
12 mund të mendojë lloj-lloj situatash ku nuk ke se si t'i  
13 përtypësh të gjitha ato materiale që do të marrësh. Mbase edhe  
14 e bëjmë. Nuk e di se çdo të thotë një dëshmitar i tillë.

15 Por nëse duam t'i bëjmë gjërat më me shpejtësi përpara  
16 dhe gjatë gjyqit, këta zotërinj po kalojnë gjithë këto vite të  
17 burgosur përpara se sa të marrin një vendim, kjo është mënyra  
18 për ta bërë punën si duhet.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 z. Emerson, ju lutem.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pikësëpari e falënderojmë z. Laws  
22 që vuri në dukje kaq qartë konsiderata nga pikëpamjet e  
23 viktimave. Ai i bën thirrje Gjykatës për t'i marrë parasysh.

24 Ai thotë, dhe ne e themi me shumë të drejtë se cilët  
25 dëshmitarë duhen thirrur, është një çështje që duhet të

1 bazohet në problemet reale të çështjes. Bazuar nga përvoja,  
2 mosmarrëveshje për ngjarje të caktuara të cilat nuk janë të  
3 lidhura me të akuzuarin mund të mos kërkojnë që të thirren  
4 dëshmitarët që të dëshmojnë drejtpërdrejtë sepse nuk  
5 diskutohet që, për shembull, krime të ndryshme mund të jenë  
6 kryer në Kosovë nga individë të ndryshëm.

7 Por çështja reale këtu është këta zotërinjtë që janë këtu  
8 të pandehur a janë ata palë në ndërmarrjen e përbashkët  
9 kriminale apo në kryerjen e këtyre krimeve apo ndryshme, janë  
10 ata përgjegjës për forma të tjera përgjegjësisë në bazë të  
11 pozitive të tyre komanduese.

12 Ai me të drejtë vë në dukje se është me interes jo vetëm  
13 të të akuzuarve që janë të ndaluar por dhe të viktimave që ai  
14 përfaqëson që gjyqi të jetë i shpejtë që të mos zgjatet në  
15 mënyrë të panevojshme.

16 Pra, pavarësisht nga ato që u tha ZPS-ja se një nga  
17 çështjet që duhet të merrni parasysh është se secili nga  
18 viktimat duhet të ketë të drejtë të vijë në Gjykatë dhe të  
19 flasë. Këtë nuk po thotë z. Laws në emër të tyre. Dhe asnjë  
20 mbështetje për këtë propozim nuk vjen nga viktimat. Ajo thotë  
21 nga vet se mund të jetë e panevojshme që disa viktimat të vijnë  
22 këtu të dëshmojnë dhe të tregojnë përvojën e tyre.

23 Pra duket se po ndiqet një qasje tjetër nga personi që ka  
24 të drejtë t'i përfaqësojë interesat e viktimave dhe ZPS-ja që  
25 duket se e përdor si pretekst për të mos ndjekur një qasje të

1 disiplinuar për përgatitjen dhe paraqitjen e çështjes së vet.

2 E dyta, është se në përputhje me hedhjen - pritjen e  
3 akuzave me Mbrojtjen në paragrafin e katërbëdhjetë të  
4 parashtrimeve të tyre ZPS-ja e ka akuzuar Mbrojtjen e Veselit  
5 për -- duke thënë se një mënyrë se si Prokuroria mund t'i  
6 bjeri shkurt çështjes së vet të fokusohet tek provat që  
7 pretendohen se lidhen me një të akuzuar të caktuar me akuzat  
8 që përmban aktakuza.

9 Kjo është keqbesim si të thuash sepse shpërfill format e  
10 përgjegjësisë për të cilën ata akuzohen. Sigurisht kur akuza  
11 me keqbesim është një akuzë mjaft e keqe. Prokuroria i hedh  
12 kështu poshtë e lartë pa ndonjë censurë këto lloj akuza. Por  
13 në fakt nuk kanë asnjë lloj bazë. Kur i njëjti parashtrim  
14 bëhet nga Mbrojtja dhe ne na akuzohet se veprojmë me keqbesim  
15 në fakt ne parashtrojmë të njëjtin parashtrim që u parashtrua  
16 tani dhe unë e kuptoj drejt, shumë mirë atë që tha z. Laws që  
17 qartësia do të rriste shpeshtësinë e ecurisë së çështjes. Pra,  
18 Prokuroria e di, është e aftë të fokusohet në prova që ata  
19 thonë se i implikon të akuzuarit.

20 Përse nuk mbështeten në to? Sepse në qoftë se merr provat  
21 që ata mbështeten për të akuzuar të akuzuarit ato bien poshtë  
22 të gjitha. Pra ato kanë shpresa se do të fitojnë thjesht nga  
23 numri i madh i dëshmitarëve që do të paraqesin.

24 Sugjerimi është që po të bësh atë që sapo sugjeroi z.  
25 Laws, apo që dhe Trupi Gjykses do ta urdhërojë Prokurorinë në



1 momentin e duhur që t'ju përmbahet provave, që lidhen me  
2 akuzuarit, Prokuroria e reziston këtë duke thënë se meqenëse  
3 është një ndërmarrje e përbashkët duhet të jemi në gjendje të  
4 thërresim gjithçka që mendojmë që ka rëndësi, përfshi edhe  
5 bazën e krimit, pra elementët e bazës së krimit. Viktimat  
6 duhet të dëgjohen, kanë pritur 20 vjet.

7 Nuk është ky funksioni i këtyre procedurave. Ato  
8 sigurisht të kryhen në interes të viktimave dhe të akuzuarit  
9 por dhe të interesit publik. Të gjitha të ekuilibruara, por  
10 kjo është detyra e Trupit Gjykses në çdo çështje penale për të  
11 siguruar që të përfshihen tre këndet, si të thuash trekëndëshi  
12 i interesave në mënyrë të balancuar.

13 Por, kjo nuk mbështet nocionin që Prokuroria ka të  
14 drejtë, ka një të drejtë të pakufizuar. Të marri tre vjet kohë  
15 për të përgatitur çështjen e vet. Gjëja tjetër që desha të  
16 thoja është se ka rëndësi të kuptojmë implikimet. Prokuroria  
17 thotë ne na duhet shumë kohë. Sipas tyre gati tre vjet. Sepse  
18 është një çështje e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale.  
19 Mbrojtja e Veselit nuk vepron me mirëbesim kur thotë, siç  
20 thatë z. Laws, të fokusohemi në çështjet reale, sepse çështja  
21 reale e Prokurorisë është tërësia e provave.

22 Duhet marrë parasysh, duhet shqyrtuar se çdo të thotë kjo  
23 sepse është paraqitur fakti ose argumentuar në momente të  
24 ndryshme se në të vërtetë është një procedim i Ushtrisë  
25 Çlirimtare të Kosovës në tërësi. Në të vërtetë Ushtria

1 Çlirimtare e Kosovës në vetvete ishte një ndërmarrje e  
2 përbashkët kriminale. Pra, ata kërkojnë të provojnë se forcat  
3 e çlirimit të një Kosove të lirë quhen si ndërmarrje e  
4 përbashkët kriminale, për të cilën akuzohen të pandehurit të  
5 cilët kishin pozita komanduese, të cilët duhet të jenë palë,  
6 duke qenë në pozitë drejtuese.

7 Ata po gjykohen siç e kemi thënë edhe më përpara sepse  
8 ishim në këtyre të luftës për çlirim. Por jo sepse kishin  
9 ndonjë faj apo ka prova kundër tyre në mënyrë individuale.

10 Fakti është që Prokuroria kundërshton thjeshtimin e  
11 çështjes, dhe nuk - siç tha z. Laws - nuk përqendrohet në  
12 faktet reale të çështje për krime të kryera kur ata s'kanë  
13 qenë fare në vend, të kryera në vende të ndryshme të Kosovës,  
14 kur nuk ka asnjë lloj prove kundër tyre. Përgjigja është që në  
15 fund të fundit Prokuroria po përpiqet të vëri në bankën e të  
16 akuzuarve Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe Qeveria Serbe  
17 mezi pret që ta shohë këtë që të ndodhi, ta deligjitimojë këtë  
18 luftë.

19 Në të vërtetë, ajo që mund të themi, është një kaos i  
20 tërë, në të cilën Prokuroria po e zhvillon çështjen e saj.

21 Ata na akuzuan ne se po gënjenim kur thamë që nuk mund të  
22 fillonte gjyqi vitin që shkoi. Ne na akuzuan të gjithë që po  
23 përpiqeshim ta frynim periudhën e përgatitjes. Dhe s'na është  
24 kërkuar asnjë falje, asnjë largim nga ky qëndrim.

25 Por në themel të kësaj nuk kanë asnjë fokus lidhur me

1 këta katër të akuzuar sepse këta janë thjesht simbol, janë  
2 anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë në pozita të larta  
3 nominale. Në qoftë se çështjen e tyre do ta bazojnë në prova  
4 se bëjnë dot se s'kanë prova, por duhet që t'u jepet disiplinë  
5 sepse do të ishte një padrejtësi e madhe që këta burra të  
6 vazhdojnë të rrinë të akuzuar për tre, katër, pesë vite të  
7 tjera, kur Prokuroria vazhdon të vijë vërdallë me çështjen e  
8 saj.

9 Që në fillim mund të themi që provat e Prokurorisë kundër  
10 këtyre individëve janë zero, nuk janë asnjë lloj prove.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, nuk shoh.

12 Z. Laws, i pari.

13 Z. LAWS: [Përkthim] Shumë shkurtë, nëse me lejoni. Unë  
14 nuk kisha për qëllim të mbështetja pretendimet apo sugjerimet  
15 e z. Emmerson siç u paraqitën në diskutimet midis palëve që  
16 kanë të bëjnë me kufizimin e çështjes së objektit të  
17 Prokurorisë. Në qoftë se krijova këtë përshtypje, shpresoj që  
18 të kuptohet nga transkripti që nuk kisha parasysh të thoja  
19 këtë.

20 Nuk bëhet fjalë për kufizimin e objektit të çështjes. Por  
21 mënyrën se si ajo paraqitet. Kjo duhet menaxhuar me kujdes.  
22 Dhe ka një dallim të madh midis këtyre dy situata. Dhe desha  
23 që të isha i qartë për këtë. Nuk po themi se provat e  
24 elementeve të krimit duhet të hiqen apo të shpërfillen nga  
25 çështja, përkundrazi ato duhen trajtuar në mënyrë efikase, gjë

1 që është e mundur pasi të identifikohej çështjen e vërteta.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Laws.

3 Z. Prokuror.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Edhe unë shkurt. Edhe unë një  
5 korrigjim. ZPS-ja nuk akuzon UÇK-në në tërësi dhe z. Emmerson  
6 e di këtë. Dhe i kërkoj të mos e përmendë më. Është një  
7 parashtrim i rrezikshëm, i pavërtetë dhe ngjan shumë me  
8 deklaratat e tyre dyzet të rinjve që u dënuan të mërkurën.  
9 Këta persona akuzohen si individë dhe jo si UÇK.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po të vazhdojmë sipas  
11 radhës.

12 Z. Kehoe, shumë shkurt.

13 Sepse u bë vonë dhe përthyesit janë shumë të lodhur.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] E kuptoj se Prokuroria nuk do ta  
15 thotë që po procedojnë UÇK-në. Por në fakt, ashtu janë duke  
16 bërë dhe për këtë mjafton të lexosh paragrafin 35 që liston  
17 pothuaj të gjithë personat e UÇK-së, në gjithë vendin si pjesë  
18 e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

19 Dhe të themi që nuk po akuzojmë Ushtrinë Çlirimtare të  
20 Kosovë është një argument fals, i rremë. Lexoni paragrafin 35  
21 ju lutem dhe do ta keni shumë të qartë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

23 Z. YOUNG: [Përkthim] Prokurori, me gjithë respektin, nuk  
24 po tregohet i vërtetë kur pretendon se nuk është një procedim  
25 kundër UÇK-së. Është një budallallëk, është e qartë se kështu

1 është. Po të shikosh në uebsajtin e Gjykatës aty flitet për  
2 përgjegjësinë individuale po është një sugjerim i pavërtetë.

3 Gjë tjetër që dua të them është sa i takon etikës. Do  
4 t'ju thoja që Prokurorisë t'i thoshit të mos fliste në këtë  
5 mënyrë. Nuk është profesionale.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

7 Nuk shoh ndonjë kërkesë për fjalën. Dhe të vazhdojmë tani  
8 tek data e konferencës së ardhshme.

9 Sikurse e kam thënë në urdhrin e punës, synoj që  
10 konferencën tjetër ta caktoj të enjten, 30 qershor 2022 në  
11 orën 14.30 të kohës së Hagës. Dhe si gjithmonë u kërkoj palëve  
12 të shprehim disponueshmërinë.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Jemi të disponueshëm.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe.

15 Z. Emerson.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] A mund të  
17 korrigjoj diçka që thashë më herët? Më mirë është ta korrigjoj  
18 sa më shpejt. Në fillim nuk fola, bëra një gabim, thashë Nazim  
19 Bllaca ka vdekur. Në fakt nuk ka vdekur. Sepse këtë gabim e  
20 kapi media, duhet korrigjuar. Nazim Bllaca.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22 Pra konferenca për 30 qershor në rregull, jeni dakord?

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

25 Z. YOUNG: [Përkthim] Jemi dakord.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po, dhe ne.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Laws

4 Z. LAWS: [Përkthim] Edhe ne jemi të gatshëm.

5 Faleminderit shumë do të merrni urdhrin e punës në  
6 momentin e duhur.

7 Tani i pyes palët pjesëmarrëse nëse ka ndonjë çështje  
8 tjetër që duan ta ngrenë.

9 Z. Prokuror.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] z. Kehoe.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kemi gjë tjetër

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

16 Z. YOUNG: [Përkthim] Jo, as ne.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Laws.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani do të bëjmë një pushim  
22 prej 10 minutash dhe pastaj do të kthehem me urdhrat gojor  
23 lidhur me çështje të cilat i përmenda më parë.

24 --- Pauza fillon në orën 18.49

25 --- Seanca rifillon në orën 19.02

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Siç e thashë edhe para  
2 pushimit do të jap tri urdhra të tjera gojarisht.

3 Tani do të jap urdhrin e dytë gojarisht lidhur me  
4 materialin 102(3).

5 Duke pasur parasysh parashtrimet e palëve urdhëroj ZPS-në  
6 që deri më 30 qershor 2022, të përfundojë rishikimin e  
7 materialit që është marrë deri në janar 2022 dhe të bëjë, të  
8 parashtrojë masat mbrojtëse përkatëse që kanë të bëjnë me  
9 rregullën 103.

10 Ky është urdhri i dytë gojarisht.

11 Ndërkohë vazhdojmë me urdhrin e tretë gojarisht që ka të  
12 bëjë me rregullën 1023.

13 Duke marrë parasysh parashtrimet e palëve, urdhëroj ZPS-  
14 në në lidhje me kërkesat ende të patrajtuara të Mbrojtës që  
15 kanë të bëjnë me materialin 102(3) të: së pari të përfundojnë  
16 trajtimin e këtyre kërkesave; së dyti të kërkojnë masa  
17 mbrojtëse ose që të parashtrojnë kundërshtimin që ka të bëjë  
18 me rëndësinë materiale; dhe së treti të nxjerrin të gjitha  
19 materiale që nuk janë objekt i masa mbrojtëse ose kërkesave  
20 për rëndësinë materiale deri më 30 shtator 2022.

21 Ky është fundi i urdhrit të tretë gojarisht.

22 Tani do të jap urdhrin e katërt gojarisht që ka të bëjë  
23 me parashtrimin e dosjeve paraprahe të Mbrojtjeve.

24 Duke marrë parasysh parashtrimet e palëve, urdhëroj  
25 ekipet e ndryshme të Mbrojtjes që të dorëzojnë dosjet

1 përkatëse paraprake deri të premtën 21 tetor 2022.

2 Ky është fundi i urdhrorit të katërt gojarisht.

3 Ky është fundi i seancës së ditës së sotme.

4 I falënderoj palët dhe pjesëmarrësit për pjesëmarrjen e  
5 tyre.

6 Falënderoj gjithashtu edhe përkthyesit, stenografët,  
7 teknikët audiovizivë dhe personelin e sigurisë për ndihmën e  
8 tyre.

9 Ky është fundi i seancës së ditës së sotme.

10 --- Konferenca për Ecurinë e Gjendjes mbyllet  
11 në orën 19.04

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25